

**UNIVERSITETI I MJEKËSISË TIRANË  
FAKULTETI I MJEKËSISË  
DEPARTAMENTI I KIRURGJISË**

**REZULTATET E TRAJTIMIT KIRURGJIKAL TË  
KANCERIT PULMONAR: VLERËSIMI PROGNOSTIK  
SIPAS KLASIFIKIMIT TË RI TNM**

**Disertacion  
Për Marrjen e Gradës Shkencore**

**DOKTOR**

**Udhëheqës Shkencor: Prof. Dr. Perlat Kapisyzi  
Disertanti: Ilir Skënduli**

**TIRANË 2022**

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I MJEKËSISË TIRANË  
FAKULTETI I MJEKËSISË**



**UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË**

**DISERTACION  
I PARAQITUR NGA  
Z. Ilir SKËNDULI**

**PËR MARRJEN E GRADËS SHKENCORE**

**DOKTOR**

**SPECIALITETI: KIRURGJI**

**TEMA: “REZULTATET E TRAJTIMIT KIRURGJIKAL TË KANCERIT  
PULMONAR: VLERËSIMI PROGNOSTIK SIPAS KLASIFIKIMIT TË RI TNM”**

**MBROHET NË DATË: ...../.....2022. PARA JURISË:**

1. ....KRYETAR
2. ....ANËTAR (OPONENT)
3. ....ANËTAR (OPONENT)
4. ....ANËTAR
5. ....ANËTAR

## ***Parathënie***

*Trajtimi kirurgjik për NSCLC është një fushë gjithnjë në zhvillim fokusuar në trajtimin e një kanceri që vazhdon të jetë i lartë vdekshmërisë. Inputi multidisiplinor është thelbësor në këta pacientë të cilët shpesh mund të kenë komorbiditete të rëndësishme mjekësore dhe paraqitjet dhe kurset e komplikuar të sëmundjeve. Në vazhdim kërkimi kirurgjik fokusohet në teknikat minimale invasive që nuk sakrifikojnë efikasitetin onkologjik dhe integrimin e sigurt të kirurgjisë me trajtime të tjera. Rezekcioni i plotë kirurgjik i NSCLC vazhdon të ofrojë mundësinë më të mirë për kurim ose kontroll lokal dhe rajonal të sëmundjes, dhe me komplikacione minimale. Sëmundshmëria e lidhur me rezeksionin kirurgjik është reduktuar.*

## **Falenderime**

Falenderoj udhëheqësin shkencor Prof. Dr. Perlat Kapisyzi për ndihmën në të gjitha etapat e studimit.

Falenderoj familjen time për mbështetjen dhe kurajon për të përfunduar me sukses këtë projekt shkencor.

## **Shkurtesa**

NSCLC	Non-small cell lung cancer
BMI	Body Mass Index
TNM	Tumour, Node, Metastasis
HR	Hazard ratio
CI	Confidence interval
FEV1	Forced expiratory volume in one second
PET	Positron emission tomography
VATS	Video assisted thoracoscopic surgery

## Përmbajtja

<i>Parathënie</i> .....	iii
Falenderime.....	iv
Shkurtesa.....	v
I HYRJE.....	x
1.0 Kancerin e Pulmonit me qeliza jo të vogla (NSCLC).....	x
1.1 Incidenca dhe Mortaliteti .....	x
1.2 Epidemiologjia .....	xi
1.3 Statistika ndërkombëtare .....	xi
1.4 Shpërndarja sipas gjinisë dhe moshës .....	xii
2.0 Anatomia .....	xiii
3.0 Tipet e Tumoreve .....	xiii
3.1 Klasifikimi Qelizor dhe Molekular i NSCLC .....	xiii
3.2 Karcinoma me qeliza skuamoze.....	xiv
3.3 Adenokarcinoma .....	xiv
3.4 Tumoret neuroendokrine .....	xv
4.0 Patogjeneza.....	xv
5.0 Faktorët e riskut.....	xvi
6.0 Skrimi.....	xvii
7.0 Shenja dhe simptoma .....	xvii
8.0 Diagnoza.....	xviii
8.1 Ekzaminimet.....	xix
9.0 Stadifikimi.....	xix
10.1 Kirurgjia .....	xx
10.1.1 Simptoma për shkak të tumorit primar.....	xx
10.2 Simptoma për shkak të përhapjes lokale .....	xxi
10.3 Simptoma sipas lokalizimit të kancerit .....	xxi
10.4 Stadifikimi.....	xxiii
10.4.1 Përfshirja e tumorit primar (T) bëhet si më poshtë.....	xxiii
10.4.2 Përfshirja e limfonodujve (N) klasifikohet si më poshtë.....	xxiv
10.4.3 Përhapja e metastazave (M) klasifikohet si më poshtë.....	xxiv
11.0 Konsiderata të trajtimit.....	xxiv
11.1 Trajtimi emergjent.....	xxvi
11.2 Trajtimi kirurgjikal.....	xxvi
11.3 Vlerësimi preoperator.....	xxvii

11.4 Lobektomia dhe pneumonektomia .....	xxvii
11.5 Wedge rezeksion/ sublobar .....	xxvii
11.6 Kirurgjia torakoskopike e asistuar me video (VATS).....	xxviii
11.7 Limfadenektomia mediastinale .....	xxviii
12.0 Vlerësimi postoperator dhe komplikacionet .....	xxviii
13.0 Menaxhimi sipas stadeve .....	xxix
14.0 Kemioterapia neoadjuvante.....	xxxiv
14.1.1 Menaxhimi.....	xxxv
14.1.2 Terapia sistemike.....	xxxv
14.1.3 Rrezatimi .....	xxxv
14.1.4 Patofiziologjia.....	xxxv
15.0 Ekspozimi ndaj karcinogjenëve .....	xxxvi
16.0 Ndjeshmëria gjenetike.....	xxxvi
17.0 Faktorët prognostikë.....	xxxvii
18.0 Risku i rekurencave.....	xxxix
19.0 Monitorimi afatgjatë.....	xl
II METODOLOGJIA .....	41
2.1 Qëllimi.....	41
2.2 Objektivat .....	41
2.3 Materiali dhe Metoda .....	42
III REZULTATE .....	45
IV DISKUTIM.....	70
V PËRFUNDIME .....	74
VI REKOMANDIME.....	76
VII SHTOJCA .....	77
VII BIBLIOGRAFIA.....	78

## Lista e tabelave

Tabela 3. 1 Karakteristikat sociodemografike dhe klinike të pacientëve .....	46
Tabela 3. 2 Karakteristikat e Ca pulmonar dhe stadifikimi .....	51
Tabela 3. 3 Lloji i komplikacioneve .....	56
Tabela 3. 4 Lloji i komplikacioneve: të hereshme dhe të vonshme.....	58
Tabela 3. 5 Risku Hazard me 95% CI sipas stadeve.....	63
Tabela 3. 6 Tipi i vdekjeve .....	65
Tabela 3. 7 Shkaku i vdekjeve dhe prania e komplikacioneve .....	65
Tabela 3. 8 Analiza multivariate e faktorëve të riskut për exitus. Regresioni i Cox .....	68

## Lista e figurave

Figura 3. 1 Shpërndarja e rasteve sipas gjinisë .....	47
Figura 3. 2 Shpërndarja e rasteve sipas grupmohës .....	47
Figura 3. 3 Statusi i duhanpirjes .....	48
Figura 3. 4 Frekuenca e sëmundjeve shoqëruese.....	48
Figura 3. 5 Lloji i sëmundjeve shoqëruese .....	49
Figura 3. 6 Shpërndarja e rasteve sipas mënyrës së diagnostikimit.....	49
Figura 3. 7 Provat respiratore.....	50
Figura 3. 8 Imazheria e përdorur.....	50
Figura 3. 9 Diferencimi i Ca .....	52
Figura 3. 10 Tipi Histopatologjik.....	52
Figura 3. 11 Madhësia e tumourit.....	53
Figura 3. 12 Prekja e limfonodulave.....	53
Figura 3. 13 Prekje e pleurës parietale.....	54
Figura 3. 14 Stadi - TNM.....	54
Figura 3. 15 Terapi neoadjuvante .....	55
Figura 3. 16 Tipi i interventit.....	55
Figura 3. 17 Figura 3. 18 Frekuenca e komplikacioneve.....	56
Figura 3. 19 Lloji i komplikacioneve.....	57
Figura 3. 20 Lloji i komplikacioneve.....	57
Figura 3. 21 Lloji i komplikacioneve: të hereshme dhe të vonshme .....	58
Figura 3. 22 Frekuenca e exitus .....	59
Figura 3. 23 Probabiliteti i mbijetesës së përgjithshme 30 ditore.....	59
Figura 3. 24 Probabiliteti i mbijetesës së përgjithshme 30 ditore sipas stadeve.....	60
Figura 3. 25 Probabiliteti i mbijetesës së përgjithshme 90 ditore.....	61
Figura 3. 26 Probabiliteti i mbijetesës së përgjithshme 90 ditore sipas stadeve.....	61
Figura 3. 27 Probabiliteti i mbijetesës së përgjithshme 5 vjeçare.....	62
Figura 3. 28 Probabiliteti i mbijetesës sipas stadeve për periudhën e ndjekjes 5 vjeçare. 62	
Figura 3. 29 Krahasimi i probabilitetit të mbijetesës sipas tipit të interventit .....	64
Figura 3. 30 Tipi i vdekjeve .....	65
Figura 3. 31 Shkaku i vdekjeve dhe prania e komplikacioneve .....	66
Figura 3. 32 Mbijetesa 5-vjeçare e pacientëve në lidhje me praninë e komplikacioneve 67	
Figura 3. 33 Analiza multivariate e faktorëve të riskut për exitus. Regresioni i Cox.....	69



## Abstrakt

**Hyrje:**Trajtimi kirurgjik për NSCLC është një fushë gjithnjë në zhvillim fokusuar në trajtimin e një kanceri që vazhdon të jetë i lartë vdekshmërisë.

**Qëllimi:**Vleresimi i rolit të trajtimit kirurgjikal të kancerit pulmonar dhe i prognozës sipas klasifikimit të TNM,

**Materiali dhe metoda:**Ky është një studim longitudinal prospektiv. Studimi është kryer në Spitalin Universitar “Shefqet Ndroqi” gjatë periudhës kohore 2010 - 2015. Nëpërmjet një skede individuale u mblodhën të dhënat sociodemografike dhe klinike.

**Rezultate:** Në studim morën pjesë 153 pacientë me moshë mesatare 65.3 ( $\pm 12.5$ ) vjeç. Shumica e pacientëve (64.1%) ishin meshkuj me ndryshim sinjifikant me femrat (35.9%). Sipas tipit histologjik mbizotëron Ca me qeliza skuamoze (49%) ndjekur nga Adenocarcinoma (35.3%), Ca me qeliza bronkoalveolare (7.2%) dhe tipi i përzier (8.5%) ( $p < 0.01$ ). Mbizotëron madhësia e tumorit  $> 30$  mm (61.5%) e rasteve. Madhësia e tumorit  $< 10$  mm u gjet në 5.2% të pacientëve, 10-20 mm në 11.8%, 21-30 mm në 21.6%, 31-50 mm në 31.4% dhe  $> 50$  mm në 30.1% ( $p < 0.01$ ). Përsa i përket prekjes së limfonodulave me No janë 66% e pacientëve, N1 janë 27.5% dhe N2 janë 6.5%. Prekje e pleurës parietale u gjet në 3.3% të pacientëve ( $p < 0.01$ ). Stadi IA janë 32% e pacientëve, IB janë 35.3%, IIA janë 12.4%, IIB janë 13.1% dhe IIIA janë 7.2% ( $p < 0.01$ ). Ditetqëndrimi mesatar spitalor është 6.5 ( $\pm 1.6$ ) ditë. Komplikacione kanë shfaqur 14.4% e pacientëve. Komplikacione madhore kanë shfaqur 6.5% e pacientëve ndërsa komplikacione minore 7.8% e tyre. Komplikacionet madhore janë 4 (2.6%) fistula bronkopleurale, 2 (1.3%) raste me hemoragji postoperative dhe përkatesisht nga 1 (0.7%) raste me insuficiencë respiratore, infarkt miokardi, empiema dhe insuficiencë renale. Mbijetesa mesatare për periudhën 90 ditore për të gjitha stadet është 61.2% ndërsa mbijetesa mesatare për periudhën 5 vjeçare për të gjitha stadet është 65.6% ose 46.9 muaj (95%CI 39.02 – 54.8) ose 4 vjet.

**Përfundim:** Prognoza e pacientëve në këtë studim ishte e përshtatshme siç reflektohet në vdekshmërinë e ulët dhe shkallën e ulët të komplikacioneve të mëdha. Mbijetesa 90 ditore dhe mbijetesa e përgjithshme 5-vjeçare ishte e pranueshme.

**Fjalë kyç:** ca pulmonime qeliza jo të vogla, TNM, rezeksion

## **I HYRJE**

### **1.0 Kancerin e Pulmonit me qeliza jo të vogla (NSCLC)**

NSCLC është çdo lloj kanceri pulmoni që nuk është me qeliza të vogla (SCLC). Llojet më të zakonshme të NSCLC janë karcinoma me qeliza skuamoze, karcinoma me qeliza të mëdha, dhe adenokarcinoma, por ekzistojnë edhe lloje të tjera që hasen më rrallë, dhe të gjitha llojet mund të ndodhin në variante të ndryshme histologjike. Ndonëse NSCLC janë të lidhura me duhanpirjen, adenokarcinoma mund të haset edhe në pacientë që nuk kanë pirë asnjëherë duhan. Krahasuar me SCLC, kanceri i pulmonit me qeliza jo të vogla është më pak i ndjeshëm ndaj kemioterapisë dhe radioterapisë. Pacientët me indikacion për rezekcion kirurgjikal, mund t'i nënshtrohen kirurgjisë ose kirurgji pasuar nga kemioterapia.

Kontrolli lokal mund të arrihet nëpërmjet radioterapisë në mjaft pacientë që nuk mund t'i nënshtrohen kirurgjisë, por kurimi arrihet vetëm në një numër të vogël pacientësh. Pacientët me sëmundje lokale të avancuar, që nuk mund të rezekohet, mund të arrijnë mbijetesë afatgjatë nëse kombinohet radioterapia me kemioterapinë. Pacientëve me sëmundje të avancuar metastatike mund t'u përmirësohet mbijetesë dhe simptomat me kemioterapi, terapi të targetuar, dhe me terapi suportive.

### **1.1 Incidenca dhe Mortaliteti**

Kanceri i mushkërive me qeliza jo të vogla përbën afërsisht 85% të të gjithë kancerave të mushkërive. Në aspektin histologjik, NSCLC ndahet në adenokarcinoma, karcinoma me qeliza skuamoze (SCC) (shih figurën më poshtë) dhe karcinoma me qeliza të mëdha. Pacientët me NSCLC kërkojnë një stadifikim të plotë për të vlerësuar shtrirjen e sëmundjes, sepse stadi luan një rol të madh në përcaktimin e modaliteteve të trajtimit.

Numri i vdekjeve dhe rasteve të reja të vlerësuara nga kanceri i mushkërisë (NSCLC dhe SCLC bashkë ) në Shtetet e Bashkuara në 2022:[1]

-Rastet e reja : 236,740.

-Vdekjet : 130,180.

Kanceri i mushkrisë është shkaku kryesor i fataliteteve nga kanceri në Shtetet e Bashkuara. Shkalla relative e mbijetesës 5 vjeçare nga 2011 në 2017 për pacientët me kancer pulmoni ishte 22%. Shkalla relative e mbijetesës 5 vjeçare varion dukshëm në pacientët e diagnostikuar në stadin e sëmundjes lokale (60%), me përhapje regjionale (33%) , ose me përhapje të largët (6%).[2]

## 1.2 Epidemiologjia

Në Shtetet e Bashkuara, kanceri i mushkërive është kanceri i dytë më i zakonshëm, pas kancerit të prostatës tek meshkujt dhe kancerit të gjirit tek femrat, dhe shkak më i zakonshëm i vdekjeve nga kanceri. Shoqata Amerikane e Kancerit parashikon që 236,740 tumore të mushkërive dhe bronkeve do të diagnostikohen në Shtetet e Bashkuara në 2022, me 130,180 vdekje.[3] Përafërsisht 85% e këtyre rasteve pritet të jenë NSCLC.

Nga viti 2009 deri në vitin 2018, incidenca e kancerit të mushkërive në SHBA u ul me pothuajse 3% në vit tek meshkujt dhe 1% në vit tek femrat. Për shkak se gratë filluan pirjen e duhanit më vonë dhe ishin më të ngadalta për ta lënë atë, rënia filloi më vonë dhe ka qenë më e ngadaltë se gratë se sa te burrat. Kjo ka rezultuar në një ngushtim të hendekut gjinor në incidencën e kancerit të mushkërive, nga më shumë se 3-fish më të larta për meshkujt në vitet 1970 në vetëm 24% më të larta në 2018.[4] Shkalla e vdekjeve nga kanceri i mushkërive për femrat amerikane është ndër më të lartat në botë. Edhe pse në Shtetet e Bashkuara, shkalla e vdekjeve është më të lartë tek meshkujt se sa tek femrat, normat për meshkujt në SHBA janë ende më të ulëta se normat në disa vende të tjera.[5] Këto tendenca në shkallën e vdekjeve në SHBA janë paralele me prevalencën e duhanpirjes gjatë 50 viteve të fundit.[6]

Megjithatë, shkalla e fataliteteve nga kanceri i pulmonit në SHBA është ulur me ritme të shpejta. Në meshkujt, shkalla e vdekjes nga kanceri i mushkërive ra 3.1% në vit në 2010-2014 dhe 5.4% në vit në 2015-2019; te femrat, rënia respektive e normave ishte 1.8% në 4.3%. Në përgjithësi, shkalla e vdekjes nga kanceri i mushkërive te meshkujt ra me 56% nga 1990 në 2019, dhe te femrat ra me 32% nga 2002 në 2019.[7]

## 1.3 Statistika ndërkombëtare

Kanceri i pulmonit është kanceri i dytë më i shpeshtë i diagnostikuar në mbarë botën, pas kancerit të gjirit, dhe incidenca e tij vazhdon të rritet. Në vitin 2020, rreth 2.2 milionë raste të reja të kancerit të mushkërive u diagnostikuan globalisht, që përbën afërsisht 11.4% të barrës globale të kancerit. Në vitin 2020 ndodhën rreth 1.8 milionë vdekje nga kanceri i mushkërive.[24] Ndër të gjitha llojet e kancerave, kanceri i mushkërive është aktualisht shkak më i zakonshëm i vdekjeve nga kanceri në shumicën e vendeve, sidomos rajonet e industrializuara si Amerika e Veriut dhe Evropa që kanë nivelet më të larta.

Ekzistojnë disa ndryshime në incidencën e kancerit të mushkërive sipas zonës gjeografike. Incidenca më e lartë ndodh në Polinezi (37.3 raste për 100,000 banorë në vit). Shkalla më e ulët e incidencës është në Afrikën perëndimore (afërsisht 2.2 raste për 100,000 banorë në vit).[8] Me rritjen e duhanpirjes në vendet në zhvillim, incidenca pritet të rritet në vitet e ardhshme, veçanërisht në Kinë dhe Indi.

Në përgjithësi, tendencat globale të kancerit të mushkërive kanë ndjekur tendencat e pirjes së duhanit, me një vonesë prej disa dekadash. Incidenca e kancerit të mushkërive ka qenë në rënie në disa vende, duke përfshirë Shtetet e Bashkuara, Kanada, Mbretërinë e Bashkuar dhe Australi, pas rënies së shkallës së duhanpirjes. Megjithatë, incidenca e kancerit të mushkërive tek gratë vazhdon të rritet në disa pjesë të globit, megjithëse ka filluar të mbetet njësoj në Shtetet e Bashkuara. Është për t'u theksuar se, pavarësisht nga shkalla shumë e ulët e duhanpirjes, femrat kineze kanë një incidencë më të lartë të kancerit të mushkërive se sa femrat evropiane.

#### **1.4 Shpërndarja sipas gjinisë dhe moshës**

Kanceri i mushkërisë ndodh kryesisht në personat e moshës 50-70 vjeç. Probabiliteti që kanceri i mushkërisë të ndodhë në të dy gjinitë në moshën nën 39 vjeç mbetet i ulët. Shanset fillojnë të rriten dhe arrijnë kulmin në të moshuarit mbi 70 vjeç. Reziku i zhvillimit të kancerit të pulmonit mbetet i lartë në meshkujt e grupmoshave mbi 40 vjeç. Në përgjithësi, kanceri i mushkërive është më i zakonshëm tek meshkujt se sa tek femrat. Në Shtetet e Bashkuara, Evropën Veriore dhe Evropën Perëndimore, prevalenca e kancerit të mushkërive ka ardhur duke u ulur te meshkujt.

Në vendet e Europës Lindore dhe Jugore, incidenca e kancerit të mushkërive është rritur me shpejtësi. Shumica e vendeve perëndimore kanë hasur në një tendencë shqetësuese të rritjes së prevalencës tek gratë dhe pacientët e moshave të reja. Gratë kanë një incidencë më të lartë të sëmundjes së lokalizuar kur paraqiten në vizitën e parë dhe të adenokarcinomës dhe zakonisht janë më të reja kur paraqesin simptoma.

Gjatë dy dekadave të fundit, incidenca e kancerit të mushkërive në përgjithësi është ulur si te burrat ashtu edhe te gratë e moshës 30 deri në 54 vjeç në të gjitha racat dhe grupet etnike. Megjithatë, incidenca ka rënë më shumë te meshkujt. Si rezultat, shkalla e kancerit të mushkërive tek femrat më të reja është bërë më e lartë se tek meshkujt më të rinj. Në pacientët e bardhë johispanikë dhe hispanikë, të moshave 44 deri në 49 vjeç, për shembull, raporti femër-mashkull për incidencën e kancerit të mushkërive u rrit nga 0.88 gjatë 1995-1999 në 1.17 gjatë 2010-2014.[9] Ky ndryshim mund të shpjegohet pjesërisht nga rritja e shkallës së duhanpirjes tek gratë e lindura që nga viti 1965.

Megjithatë, ndërsa diferenca në normat e duhanpirjes në atë grupmoshë është ngushtuar, normat tek gratë në përgjithësi nuk i kanë tejkaluar normat e meshkujve, kështu që ndoshta luajnë rol edhe faktorë të tjerë. Për shembull, gratë mund të jenë më të ndjeshme ndaj efekteve onkogjene të pirjes së duhanit.[10]

## 2.0 Anatomia

NSCLC rrjedh nga qelizat epiteliiale të mushkërisë nga bronket kryesore drejt alveolave terminale. Tipi histologjik i NSCLC korrelohet me vendin e origjinës, çka reflekton variacionin e epitelit të traktit respirator të bronkeve nga alveolat. Karcinoma me qeliza skuamoze zakonisht fillon pranë një bronku kryesor. Adenokarcinoma dhe karcinoma bronkioloalveolare zakonisht e merr origjinën në indet periferike pulmonare.



Kanceri i mushkërive me qeliza jo të vogla.

Një karcinomë me qeliza skuamoze kavitare e lobit të poshtëm të djathtë

## 3.0 Tipet e Tumoreve

### 3.1 Klasifikimi Qelizor dhe Molekular i NSCLC

Tumoret epiteliiale malinje me qeliza jo të vogla të mushkërive klasifikohen nga Organizata Botërore e Shëndetit (OBSH)/Shoqata Ndërkombëtare për Studimin e Kancerit të Mushkërive (IASLC). Ekzistojnë tre nëntipe kryesore të kancerit të mushkërive me qeliza jo të vogla (NSCLC), duke përfshirë sa vijon:

- Karcinoma me qeliza skuamoze (25% të tumoreve të mushkërisë).
- Adenokarcinoma (40% të tumoreve të mushkërisë).
- Karcinoma me qeliza të mëdha (10% të tumoreve të mushkërisë).

Tipe të tjera mund të jenë karcinoma adenoskuamoze, karcinomat sarkomatoide, tipet e tumoreve të gjëndrave të pështymës, tumoret karcinoide, dhe karcinomat e tjera të paklasifikuara. Në këto kategori ka mjaft nëntipe.[11]

### 3.2 Karcinoma me qeliza skuamoze

Shumica e karcinomave me qeliza skuamoze të mushkërisë kanë lokalizim qendror, në bronket e mëdha të mushkërisë. Karcinomat me qeliza skuamoze janë më tepër të lidhura me duhanpirjen krahasuar me format e tjera të NSCLC. Incidenca e karcinomës me qeliza skuamoze të mushkërisë është ulur në vitet e fundit.

### 3.3 Adenokarcinoma

Adenokarcinoma tashmë është nëntipi histologjik më i zakonshëm në shumë vende dhe nënklasifikimi i adenokarcinomës është mjaft i rëndësishëm. Një nga problemet më të mëdha me adenokarcinomën e mushkërisë është heterogjeniteti i shpeshtë histologjik. Përzierjet e nëntipave histologjike të adenokarcinomës janë më të zakonshme se tumoret që përbëhen thjesht nga një model i vetëm i adenokarcinomës acinare, papilare, bronkioloalveolare dhe solide me formim mucine.

Kriteret për diagnozën e karcinomës bronkioloalveolare kanë ndryshuar shumë në të kaluarën. Përkufizimi aktual i OBSH/IASLC është shumë më kufizues sesa ai i përdorur më parë nga shumë patologë, sepse është i kufizuar vetëm në tumoret joinvazive.

Nëse në një adenokarcinomë që ka një komponent të gjerë të karcinomës bronkioloalveolare, identifikohet invazion stromal, vaskular ose pleural, klasifikimi do të ishte një adenokarcinomë e nëntipit të përzier me model bronkioloalveolar mbizotërues dhe një model fokal acinar, solid ose papilar në varësi të modelit që shihet në komponentin invaziv. Megjithatë, e ardhmja e karcinomës bronkioloalveolare si një entitet klinik i veçantë është e paqartë; një panel ekspertësh multidisiplinar që përfaqëson IASLC, Shoqatën Amerikane të Toraksit dhe Shoqatën Evropiane të Frymëmarrjes propozoi një rishikim të madh të klasifikimit të adenokarcinomave në 2011 që përfshin një riklasifikim të asaj që quhej karcinoma bronkioloalveolare në nëngrupe histologjike të reja. [12]

Variantet e mëposhtme të adenokarcinomës njihen në klasifikimin e OBSH/IASLC :

- Adenokarcinoma fetale e mirëdiferencuar.
- Adenokarcinoma Mucinoze (koloide).
- Cistadenokarcinoma Mucinoze
- Adenokarcinoma me unazë me vulë.
- Adenokarcinoma me qeliza të qarta.  
Karcinoma me qeliza të mëdha

Përveç kategorisë së përgjithshme të karcinomës me qeliza të mëdha, disa variante të pazakonta njihen në klasifikimin OBSH/IASLC, duke përfshirë sa vijon:

- Karcinoma me qeliza të mëdha neuroendokrine (LCNEC).
- Karcinoma bazaloide.
- Karcinoma e ngjashme me Limfoepiteliomën.
- Karcinoma me qeliza të qarta. Karcinoma me qeliza të mëdha me fenotip rabdoid. Karcinoma bazaloide njihet gjithashtu si një variant i karcinomës me qeliza skuamoze dhe rrallë, adenokarcinomat mund të kenë një model bazaloid; megjithatë, në tumoret pa asnjërën nga këto karakteristika, ato konsiderohen si një variant i karcinomës me qeliza të mëdha.

### **3.4 Tumoret neuroendokrine**

LCNEC njihet në aspektin histologjik si një karcinomë me qeliza jo të vogla e shkallës së lartë. Ka një prognozë shumë të keqe të ngjashme me atë të kancerit të pulmonit me qeliza të vogla (SCLC). Karcinoidi atipik njihet si një tumor neuroendokrin i shkallës së ndërmjetme me një prognozë që shkon midis karcinoidit tipik dhe SCLC të shkallës së lartë dhe LCNEC.

Diferencimi neuroendokrin mund të demonstrohet me imunohistokimi ose mikroskopi elektronike në 10% deri në 20% të NSCLC-ve të zakonshme që nuk kanë morfologji neuroendokrine. Këta tumore nuk njihen zyrtarisht në skemën e klasifikimit të OBSH/IASLC sepse rëndësia klinike dhe terapeutike e diferencimit neuroendokrin në NSCLC nuk është vërtetuar plotësisht. Këta tumore quhen NSCLC me diferencim neuroendokrin. [13]

### **4.0 Patogjeneza**

Karcinogjeneza pulmonare e lidhur me duhanpirjen është një proces me shumë hapa. Karcinoma me qeliza skuamoze dhe adenokarcinoma kanë leziona perkursore premalinjante të përcaktuar. Përpara se të bëhet invaziv, epiteli i mushkërive mund të pësojë ndryshime morfologjike që përfshijnë sa vijon:

- Hiperplazia.
- Metaplazia.
- Displazia.
- Karcinoma in situ.

Displazia dhe karcinoma in situ konsiderohen si lezionet kryesore premalinje sepse ato kanë më shumë gjasa të përparojnë drejt kancerit invaziv dhe më pak të ngjarë të regredojnë spontanisht.

## 5.0 Faktorët e riskut

Mosha e madhe është faktori kryesor i rrezikut për shumicën e kancerave. Faktorë të tjerë risku për kancerin e mushkërisë përfshijnë sa më poshtë:

- Histori përdorimi ose duhanpirje aktuale: cigare, llullë, dhepuro.[14]
- Ekspozim ndaj substancave që shkaktojnë kancer gjatë duhanpirjes pasive.
- Ekspozim në punë ndaj azbestit, arsenikut, kromit, beriliumit, nikelit, dhe agjentëve të tjerë.
- Ekspozim rrezatues ndaj ndonjë si më poshtë :
  - Radioterapi e gjirit ose kraharorit.
  - Ekspozim ndaj radonit në shtëpi ose punë.
- Ekzaminime imazherike mjekësore, si tomografia e kompjuterizuar (CT).
- Jetesa në zona me ajër të ndotur.
- Histori familjare të kancerit të pulmonit.
- Infeksion nga Virusi i Imunodeficiencës humane.
- Suplementet me Beta karotennë duhanpirësit e rëndë.[15]

Faktori i vetëm më i rëndësishëm për zhvillimin e kancerit të pulmonit është duhanpirja. Për duhanpirësit, rreziku i kancerit të mushkërive është mesatarisht 10 herë më i lartë krahasuar me jofumatorët (përkufizuar si individë që kanë konsumuar më pak se 100 cigare gjatë jetës). Rreziku rritet në varësi të numrit të cigareve të konsumuara, kohëzgjatjes së duhanpirjes, dhe moshës kur ka filluar duhanpirja.

Ndërprerja e duhanpirjes çon në ulje të lezioneve prekanceroze dhe reduktim të riskut për të zhvilluar kancer pulmoni. Ish fumatorët vazhdojnë të kenë një risk të shtuar për kancerin e pulmonit edhe pas disa vitesh pas ndërprerjes. Ekspozimi ndaj asbestit mund të shfaqë një efekt sinergjik me duhanpirjen sa i përket riskut për kancer pulmoni.[16]

Përveç kësaj, pas heqjes së kancerit të mushkërive, ekziston një rrezik 1% deri në 2% për pacient në vit që të ndodhë një kancer i dytë i mushkërive.[17]

Një numër i konsiderueshëm pacientësh të shëruar nga kanceri i pulmonit i lidhur me duhanpirjen, mund të zhvillojnë një malinjancë tjetër. Në Grupin e Studimit të Kancerit të Mushkërive me 907 pacientë me tumore të rezekuar në fazën T1, N0, shkalla e zhvillimit të kancerit të dytë jopulmonar ishte 1.8% në vit dhe 1.6% në vit për kanceret e reja pulmonare.[18] Studime të tjera kanë raportuar shkallë edhe më të lartë rrezikutë



tumoreve sekondare në të mbijetuarit afatgjatë, duke përfshirë normat prej 10% për kancerin sekondar pulmonardhe 20% për të gjitha kancerat sekondarë. Për shkak të riskut të vazhdueshëm për të zhvilluar kancer pulmoni sekondar në ish fumatorët, në mjaft studime të randomizuara janë vlerësuar strategji të ndryshme kemiopreventive. Asnjë nga studimet e fazës III që përdorin agjentët beta karoten, retinol, acid 13-cis-retinoik, [alfa]-tokoferol, N-acetilcisteinë ose acid acetilsalicilik nuk ka treguar rezultate të dobishme dhe të riprodhueshme.[19] Kimioparandalimi i kancerit të dytë primar të traktit të sipërm aerodigjestiv po i nënshtrohet vlerësimit klinik te pacientët me kancer të mushkërive në fazë të hershme.

## **6.0 Skrinimi**

Në pacientët që konsiderohen me risk të lartë për të zhvilluar kancer pulmoni, i vetmi modalitet për depistimin e hershëm dhe që ka treguar se mund të ndryshojë shkallën e mortalitetit, është CT skaneri low-dose. [20] Studimet e skrinimit të kancerit të pulmonit me radiografi toraksi dhe citologji të sputumit kanë treguar se skrinimi me këto modalitete nuk e ul shkallën e vdekshmërisë nga kanceri i pulmonit.

## **7.0 Shenja dhe simptoma**

Kanceri i pulmonit është shpesh tinëzar, duke mos shfaqur simptoma derisa sëmundja të përparojë mirë. Në afërsisht 7-10% të rasteve, kanceri i mushkërive diagnostikohet te pacientët asimptomatikë kur kryhet një radiografi toraksi për arsye të tjera që zbulon sëmundjen.

Në fazat e para të diagnostikimit, 20% e pacientëve kanë sëmundje të lokalizuar, 25% e pacientëve kanë metastaza regjionale dhe 55% e pacientëve kanë përhapje të largët të sëmundjes.

Shenjat dhe simptomat e kancerit të mushkërive mund të jenë për shkak të tumorit primar, përhapjes lokale, sëmundjes metastatike ose prodhimit të hormoneve ektopike (shih figurën më poshtë). Kolla raportohet të jetë simptoma më e zakonshme e kancerit të mushkërive. Simptoma të tjera respiratore përfshijnë dispnenë, dhimbjen e gjoksit dhe hemoptizinë. Hemoptizia përshkruhet si një simptomë që shpesh shkakton një paraqitje më të shpejtë. [21]

NSCLC është shpesh tinëzare, duke mos shfaqur simptoma derisa sëmundja të përparojë mirë. Njohja e hershme e simptomave mund të jetë e dobishme për rezultatin përfundimtar.

Në fazat e para të diagnostikimit, 20% e pacientëve kanë sëmundje të lokalizuar, 25% e pacientëve kanë metastaza regjionale dhe 55% e pacientëve kanë përhapje të largët të sëmundjes. Simptomat varen nga lokalizimi i kancerit. [22]

Shenjat dhe simptomat më të zakonshme të kancerit të mushkërive përfshijnë si më poshtë:

- Kollë
- Dhimbje gjoksi
- Dispne
- Kollitje me gjak
- Fishkëllima
- Ngjirje zëri
- Infeksione rekurente si bronkiti dhe pneumonia
- Rënie në peshë dhe mungesëoreksi
- Lodhje

Shenjat dhe simptomat e përhapjes së sëmundjes mund të përfshijnë si më poshtë:

- Dhimbje kockash
- Dëmtim i shtyllës kurrizore
- Probleme neurologjike si dhimbje koke, dobësi ose mpirje të gjymtyrëve, vertigo dhe konvulsione

## **8.0 Diagnoza**

Ekzaminimet investiguese të pacientëve që dyshohen për NSCLC fokusohen në konfirmimin e diagnozës dhe përcaktimin e shtrirjes së sëmundjes. Alternativat e trajtimit për pacientët përcaktohen nga histologjia, stadi dhe gjendja e përgjithshme dhe komorbiditetet e pacientit.

Procedurat e përdorura për të përcaktuar praninë e kancerit përfshijnë si më poshtë:

- Historia.
- Ekzaminimi fizik
- Ekzaminimet laboratorike rutine.
- Radiografia e toraksit.
- CT skan i toraksit me kontrast.
- Biopsia.

Përpara se një pacient të fillojë trajtimin e kancerit të mushkërive, një pneumolog me përvojë në kancerin e mushkërive duhet të rishikojë materialin patologjik.

Kjo është e rëndësishme sepse SCLC, që i përgjigjet mirë kimioterapisë dhe në përgjithësi nuk trajtohet me kirurgji, mund të ngatërrohet në ekzaminimin mikroskopik me NSCLC.[23] Imunohistokimia dhe mikroskopia elektronike janë teknika të paçmueshme për diagnostikimin dhe nënklasifikimin, por shumica e tumoreve të mushkërive mund të klasifikohen sipas kriterëve mikroskopike të lehta.

### **8.1 Ekzaminimet**

Pas ekzaminimit fizik dhe laboratorik, radiografia e toraksit është shpesh testi i parë që kryhet. Radiografia e toraksit mund të tregojë :

- Nodus, masë ose infiltrim pulmonar
- Zgjerim mediastinal
- Atelektaza
- Zgjerim hilar
- Efuzioni pleural

Ka disa metoda për të konfirmuar diagnozën, ku zgjedhja përcaktohet pjesërisht nga vendndodhja e lezionit. Këto metoda përfshijnë si më poshtë:

- Bronkoskopia
- Ekzaminimi citologjik i sputumit
- Mediastinoskopia
- Torakocenteza
- Torakoskopia
- Biopsi transtorakale (e udhëhequr nga CT ose fluoroskopi)

### **9.0 Stadifikimi**

Një CT scan i krahavorit është standardi për stadifikimin e kancerit të mushkërive. Sistemi i stadifikimit TNM (tumor-limfonoduj-metastaza) nga Komiteti Amerikan për Stadifikimin e Kancerit dhe Raportimin e Rezultateve Përfundimtare përdoret për të gjitha karcinomat e mushkërive, përveç kancerit të mushkërive me qeliza të vogla.

TNM bazohet në informacionet kryesore të mëposhtme:

- T - përshkruan madhësinë e tumorit primar
- N - përshkruan përhapjen e kancerit në limfonodujt regjionale
- M - tregon nëse kanceri ka metastazuar

Përfshirja e tumorit primar (T) është si më poshtë:

- Tx - Tumori primar nuk mund të vlerësohet
- T0 - Nuk ka evidencëtë tumorit
- Tis - Karcinoma in situ

- T1, T2, T3, T4: madhësia dhe/ose shtrirja e tumorit primar

Përfshirja e limfonodujve (N) është si më poshtë:

- Nx - Limfonodujt regjionale nuk mund të vlerësohen
- N0 - Nuk ka metastaza në limfonodujt regjionale
- N1 - Metastaza në limfonodujt hilare ipsilaterale dhe/ose peribronkiale ipsilaterale dhe limfonodujt intrapulmonare, duke përfshirë dhe përhapjen nga shtrirja drejtpërdrejtë
- N2 - Metastaza në limfonodujt mediastinale dhe/ose subkarinale ipsilaterale
- N3 - Metastaza në limfonodujt mediastinale kontralaterale, hilare kontralaterale, cervikalë ipsilaterale ose kontralaterale, ose supraklavikulare. [24]

Përfshirja metastatike (M) është si më poshtë:

- M0 - Nuk ka metastaza
- M1 - Metastaza të largëta

Prania e efuzionit pleural e stadifikon sëmundjen në stadin 4.

## **10.0 Menaxhimi**

Kirurgjia, terapia sistemike dhe radioterapia janë opsionet kryesore të trajtimit për NSCLC. Për shkak se shumica e kancereve të mushkërive nuk mund të trajtohen me modalitetet terapeutike aktuale, në pacientët me NSCLC aplikimi i duhur i kujdesit paliativ të kualifikuar është një pjesë e rëndësishme e trajtimit.

## **10.1 Kirurgjia**

Kirurgjia është trajtimi i zgjedhur për stadin I dhe stadin II të NSCLC. Mund të përdoren disa lloje të ndryshme të kirurgjisë, si më poshtë:

- Lobektomia – heqja e një pjese të mushkërive
- Pulmonektomia – heqja e të gjithë mushkërisë
- Rezekcioni – heqja e një pjese të një lobi

### **10.1.1 Simptoma për shkak të tumorit primar**

Simptomat e prodhuara nga tumori primar varen nga vendndodhja e tij (p.sh. qendrore, periferike). [25] Tumoret qendrore janë në përgjithësi karcinoma me qeliza skuamoze (SCC) dhe prodhojnë kollë, dispne, atelektazë, pneumoni postobstruktive, fishkëllima dhe hemoptizi.

Shumica e tumoreve periferike janë adenokarcinoma ose karcinoma me qeliza të mëdha dhe, përveçse shkaktojnë kollë dhe dispne, mund të shkaktojnë simptoma për shkak të efuzionit pleural dhe dhimbje të forta si rezultat i infiltrimit të pleurës parietale dhe paretit torakal. Për shkak të lokalizimit periferik, adenokarcinomat mund të mos

evidentohen derisa prodhojnë metastaza ekstratorakale. Për shembull, pacientët mund të paraqesin shenja klinike të përhapjes kockore ose intrakraniale. [26]

### **10.2 Simptoma për shkak të përhapjes lokale**

Simptomat për shkak të përhapjes lokoregjionale mund të përfshijnë obstrukcionin e venës kava superiore, paralizën e nervit rekurens laringeal dhe paralizën e nervit frenik, duke shkaktuar ngjirje zëri dhe paralizë të diafragmës; presion në pleksin simpatik, duke shkaktuar sindromën Horner; disfagi që rezulton nga komprimimi i ezofagut; dhe likid perikardial.

Tumoret e lobeve superiore (tumoret Pancoast) mund të shkaktojnë komprimim të rrënjëve të pleksit brakial në vendin ku dalin nga foramina neurale, duke rezultuar në dhimbje irraduese neuropatike intense, në ekstremitetin e sipërm ipsilateral.

### **10.3 Simptoma sipas lokalizimit të kancerit**

Kancerat endobronkialë mund të prodhojnë shenjat e mëposhtme:

- Kollë (45-75% e pacientëve)
- Hemoptizi (57%)
- Obstrukcion bronkial
- Komplikacione postobstruktive (psh, pneumoni, efuzion pleural)

Kancerat mediastinalë mund të japin shenjat dhe simptomat e mëposhtme:

- Dispne
- Kollë Postprandiale (ezofageale)
- Fishkëllima (Wheezing)
- Stridor (obstrukcion i rrugëve të sipërme respiratore, 2-18%)
- Ngjirje zëri (paralizë e kordës vokale të majtë për shkak tështypjes së nervit larungeal rekurens , 2-18%)
- Kilotoraks (duktus toracik)
- Palpitacione (perikardiale)
- Disfagia (zmadhimi i limfonodujve subkarineale mund të shkaktojë disfagi duke komprimuar një të tretën e ezofagut)

Kanceri i pleurës mund të japë shenjat dhe simptomat e mëposhtme:

- Dhimbje gjoksi (27-49%)
- Dispne (37-58%)
- Kollë (45-75%)

Shenjat dhe simptomat neurologjike përfshijnë si më poshtë:

- Dobësi dhe parestezi të krahëve (shtypje e pleksit brakial)

- Miozë, ptozë, dhe anhidrozë (zinxhiri cervikal simpatik, sindromi Horner)
- Dispne (sekondarenga paraliza e nervit frenik)

Kanceri metastatik mund të japë shenjat e mëposhtme (8-68%):

- Rënie në peshë
- Kaheksi

Shenja dhe simptoma të sistemit nervor qendror (CNS) përfshijnë:

- Cefale
- Alterim i statusit mendor
- Konvulsione
- Meningizëm
- Ataksi
- Nauze dhe/ose të vjella

Shenjat vaskulare përfshijnë:

- Flebiti
- Tromboembolia (sindroma Trousseau)

Manifestimet muskuloskeletike përfshijnë:

- Dhimbje të kockave (6-25%)
- Shtypje e palcës kurrizore

Sindromat paraneoplazike ndodhin në 10-20% të pacientëve. Shumica e sindromave paraneoplazike shkaktohen nga kanceri i pulmonit me qeliza të vogla (SCLC). Megjithatë, këto sindroma mund të shkaktohen edhe nga kanceri i pulmonit me qeliza jo të vogla (NSCLC). Disa shembuj janë paraqitur më poshtë: [27]

Hiperkalçemia për shkak të prodhimit të hormonit të ngjashëm me PTH ndodh më shpesh te pacientët me SCC.

Gishtat clubbing dhe osteoartropatia hipertrofike pulmonare dhe sindromi Trousseau i hiperkoagulabilitetit shkaktohen më shpesh nga adenokacinomat.

Sidroma e sekretimit të papërshtatshëm të hormonit antidiuretik (SIADH) është më e shpeshtë në rastet me SCLC por mund të ndodhë edhe nëNSCLC.

Sindromi Cushing nga prodhimi ektopik i hormonit adrenokortikotropik (ACTH) ndodh më shpesh në SCLC ose në karcinoidin bronkial [28].

## 10.4 Stadifikimi

Indikatori më i rëndësishëm prognostik në kancerin e pulmonit është përhapja e sëmundjes dhe përfshirja e limfonodujve. Komiteti Amerikan për Stadifikimin e Kancerit dhe Raportimin e Rezultateve Përfundimtare ka zhvilluar sistemin TNM (tumor-limfonoduj-metastaza) të stadifikimit, i cili merr vlerëson përhapjen e tumorit primar, shtrirjen e limfonodujve regjionalë të prekur, dhe praninë ose mungesën e matstazave të largëta (shiko tabelën mëposhtë). Sistemi TNM përdoret për të gjitha llojet e karcinomave pulmonare përveç SCLC.

Sistemi i stadifikimit dhe grupimit TNM

### 10.4.1 Përfshirja e tumorit primar (T) bëhet si më poshtë:

- TX - Tumori primar nuk mund të vlerësohet
- T0 - Nuk ka evidencë të tumorit
- Tis - Karcinoma in situ; karcinoma me qeliza skuamoze in situ ; adenokarcinoma in situ; adenokarcinoma me modelin e rritjes lepidike, deri në 3 cm në matjen më të madhe
- T1 – Tumori nën 3 cm në matjen më të madhe, rrethuar nga mushkëria ose pleura viscerale, pa të dhëna bronkoskopike të infiltrimit të bronkut, më tepër proksimal sesa bronkut lobar (jo në bronkun kryesor )
- T1mi –Adenokarcinoma minimalisht invazive: adenokarcinoma (nën 3 cm në matjen më të madhe ) me model mbizotërues lepidik dhe më pak se 5 mm infiltrim në matjen më të madhe
- T1a – Tumor nën 1 cm në matjen më të madhe
- T1b - Tumor më shumë se 1 cm por më pak se 2 cm
- T1c - Tumor më shumë se 2 cm por më pak se 3 cm
- T2 - Tumor më shumë se 3 cm, por më pak se 5 cm, ose me ndonjë nga karakteristikat e mëposhtme: (1) Përfshin bronkun kryesor, pavarësisht nga distanca nga karina, por pa përfshirjen e karinës; (2) Përfshin pleurën viscerale (PL1 ose PL2); (3) Shoqërohet me atelektazë ose pneumoni obstruktive që shtrihet në regjionin hilar, duke përfshirë një pjesë ose të gjithë mushkërinë
- T2a - Tumor më shumë se 3 cm por më pak se 4 cm
- T2b - Tumor më shumë se 4 cm por më pak se 5 cm. [29]
- T3 - Tumor më shumë se 5 cm, por më pak se 7 cm, ose një që përfshin ndonjë nga strukturat sa vijon: pleura parietale (PL3), paretit torakal (duke përfshirë tumoret e sulkusit superior), nervi frenik, perikardi parietal; ose noduse të veçuara të tumorit në të njëjtin lob si tumori primar.
- T4 - Tumor më shumë se 7 cm, ose i çdo madhësie që invadon një ose më shumë nga sa vijon: diafragma, mediastini, zemra, enët e mëdha, trakeja, nervi laringeal rekuren, ezofag, trupat vertebralë, karina; noduse të veçuara të tumorit në lobin ipsilateral të ndryshëm nga tumori primar

#### **10.4.2 Përfshirja e limfonodujve (N) klasifikohet si më poshtë :**

- NX –Limfonodujt regjionalë nuk mund të vlerësohen
- N0 – Nuk ka metastaza në limfonodujt regjionalë
- N1 – Metastaza në limfonodujt peribronkialë ipsilateralë dhe/ose hilare ipsilaterale dhe limfonoduj intrapulmonare nga shtrirja e drejtpërdrejtë
- N2 – Metastaza në limfonodujt mediastinalë ipsilateralë dhe/ose subkarinealë
- N3 – Metastaza në limfonodujt mediastinale kontralaterale, hilarekontralaterale, cervikalë ipsilaterale ose kontralaterale, ose supraklavikulare

#### **10.4.3 Përhapja e metastazave (M) klasifikohet si më poshtë:**

- MX –Metastazat në distancë nuk mund të vlerësohen
- M0 –Pa metastaza në distancë
- M1 –Metastaza të largëta
- M1a –Noduse tumorale të veçuara në lobin kontralateral; tumor me limfonoduj pleural ose perikardialë ose efuzion pleural ose pericardial malinj
- M1b –Metastaza solitare ekstratorakale në një organ të vetëm (including involvement of a single nonregional node)
- M1c –Metastaza multiple ekstratorakale në një ose më shumë organe

Grupet prognostike të AJCC për NSCLC përfshijnë 4 stade, me nënndarje të mëtejshme të stadeve në nëntipe. [30]

### **11.0 Konsiderata të trajtimit**

Kirurgjia është trajtimi i zgjedhur për pacientët me kancer të mushkërive me qeliza jo të vogla (NSCLC) në stadin I deri në IIIA. Përveç kësaj, pacientët me kancer pulmonari të rezekuar kanë një rrezik të lartë të relapsit të sëmundjes dhe shpesh trajtohen edhe me kimioterapi adjuvante. Pacientëve në stadin IIIB dhe IV të NSCLC zakonisht u aplikohet kimioterapi edhe me opsionin e kirurgjisë. Terapia e targetuar molekulare luan një rol gjithnjë e më të rëndësishëm në trajtimin e NSCLC të avancuar.

Suksesi i terapisë së targetuar molekulare në NSCLC të avancuar ka rritur interesin në terapinë preoperative të NSCLC të rezequeshme në fazën e hershme. [31] Në mars 2022, Administrata Amerikane e Ushqimit dhe Barnave (FDA) miratoi përdorimin neoadjuvant të inhibitorit të kontrollit imunitar nivolumab, në kombinim me kimioterapinë e dyfishtë me platin, për pacientët me NSCLC të rezequeshme (tumore  $\geq 4$  cm ose limfonoduj pozitive). Miratimi u bazua në rezultatet e studimit CheckMate 816, i cili përfshinte pacientë me stadin IB, II, ose IIIA të NSCLC. [77] Studimet e agjentëve të tjerë biologjikë për terapinë neoadjuvante janë aktualisht në progres.



Rrezatimi është një opsion i arsyeshëm për trajtimin e pacientëve që nuk janë kandidatë për kirurgji. Roli i radioterapisë adjuvante pas rezeksionit të tumorit primar mbetet i diskutueshëm.

Duke qënëse shumica e NSCLC nuk mund të trajtohen me modalitetet terapeutike të disponueshme aktualisht, aplikimi i duhur i kujdesit paliativ të kualifikuar është një pjesë e rëndësishme e trajtimit. Dëshmitë në rritje mbështesin ofrimin e kujdesit paliativ në të njëjtën kohë me kujdesin standard onkologjik qysh në diagnozën fillestare të NSCLC të avancuar. [32]

Vlerësimi i karakteristikave klinike, anatomo-patologjike dhe stadeve tek pacientët me Ca bronko-pulmonar

- -Diferencimi dhe tipi histopatologjik i tumorit
- -Prekja e limfonodulave mediastinale
- -Madhesia e tumourit
- -Stadi-TNM

Vlerësimi i prognozës së pacientëve

- -Frekuenca dhe lloji i komplikacioneve
- -Frekuenca e exitus

Vlerësimi i mbijetesës për totalin e pacientëve dhe sipas stadeve dhe tipit të interventit

Përcaktimi i faktorëve prognostikë të vdekshmerisë postoperatore

## 2.3 Materiali dhe Metoda

**Tipi i studimit:** Ky është një studim, longitudinalprospektiv.

**Vendi dhe periudha e kryerjes:**

Studimi është kryer në Spitalin Universitar “Shefqet Ndroqi” gjatë periudhës kohore 2010 - 2015.

**Kriteret e përfshirjes në studim**

Të gjithë pacientët me NSCLC primare: adenokarcinoma dhe karcinoma skuamoze

**Kriteret e përjashtimit nga studimi**

Përjashtuam pacientët:

që iu nënshtruan torakotomisë eksplorative,  
Kirurgjia torakoskopike e asistuar me video (VATS),  
metastasektomi pulmonare,  
procedurë paliative ose rezeksion vetëm për biopsi.

Pacientët u përjashtuan gjithashtu kur diagnoza patologjike postoperative tregoi një nga tipet e mëposhtëme:

- karcinoma cistike adenoide,
- karcinoid tipik ose sarkoma.

Insuficiencë e rëndë kardiake dhe provat FEV1 <40%

**Nëpërmjet një skede individuale u mblodhën të dhënat sociodemografike dhe klinike**

Të dhënat sociodemografike:

- Moshë
- Gjinia
- BMI

Ish-duhanpirës u përkufizuan si pacientë që kishin lënë duhanin në kohën e shtrimit në spital, dhe ata që nuk pinë kurrë duhan u përkufizuan si pacientë që nuk kishin pirë asnjë cigare ose më pak se 100 cigare gjatë jetës së tyre.

Në vlerësimet klinike përfshihen:

- Semundjet shoqëruese
- Indeksi Karnofski

- Menyra e diagnozës
- Provat respiratore
- CEA

-Ekzaminimet imazherike

- Rtg pulmoni
- CT toraksi ne dinamikë
- PET/CT+ MRI koke
- EBUS
- Video-mediastinoskopi

-Karakteristikat e Ca Pulmonar dhe stadifikimi

- Tipi Histopatologjik dhe lokalizimi i tumorit
- Madhesia e tumorit ne kontekstin e stadifikimit TNM
- Prekja e limfonodulave mediastinale dhe hilare në funksion të stadifikimit TNM
- Prekje e pleures parietale
- Stadi
- Tipi i interventit

Frekuenca dhe lloji i komplikacioneve

Ditëqëndrimi

Frekuenca e exitus

-Të gjithë pacientët u ndoqën periodikisht me CT toraksi pas interventit në:

- 3 muaj,
- 6 muaj,
- 1 vit,
- 2 vjet
- 3 vjet
- 5 vjet

-Klasifikimi i komplikacioneve sipas Sistemit Clavien-Dindo

Komplikacionet postoperatore u klasifikuan duke përdorur sistemin Clavien-Dindo, i cili i kategorizon komplikacionet postoperative në pesë grupe të mëdha sipas ndërhyrjes së kërkuar për kujdesin ndaj pacientit:

-grada 1, që nuk kërkon ndërhyrje farmakologjike përveç antiemetikëve, antipiretikëve, analgjezikëve, diuretikëve, elektroliteve dhe fizioterapisë;

-grada 2, që kërkon ndërhyrje farmakologjike me barna të ndryshme nga ato të lejuara për komplikacionet e shkallës 1;

-grada 3, që kërkon ndërhyrje të mëtejshme me ose pa anestezi të përgjithshme;

-grada 4, komplikacionet kërcënuese për jetën dhe ato që kërkojnë menaxhim të njësisë së kujdesit intensiv

-grada 5, vdekja e pacientëve (10).

## 2.4 Metodologjia e analizës statistikore

Për analizën e të dhënave është përdorur programi statistikor SPSS 25.0. Variablat e vazhdueshëm janë përmbledhur si mesatare  $\pm$  deviacionin standard (SD).

Për variablat kategorike është llogaritur përqindja e pacientëve në çdo kategori.

Është përdorur testi  $\chi^2$  dhe *Fischer exact test* për krahasimin e përqindjes ndërmjet variablove kategorikë.

Është përdorur testi i studentit *t* dhe ANOVA për krahasimin e mesatereve të parametrave të variablove të vazhduar.

Është përdorur analiza e kurbave Kaplan-Meier për vlerësimin e mbijetesës postoperatore të pacientëve .

Është përdorur analiza multivariate e regresionit Cox i cili kontrollon për konfunduesit e mundshëm, për vlerësimin e faktorëve prediktorë të exitus.

Vlera e  $p \leq 0.05$  u konsiderua statistikisht e rëndësishme.


Të gjitha testet statistikore janë të dyanshme.

### III REZULTATE

**Tabela 3. 1**Karakteristikat sociodemografike dhe klinike të pacientëve


Variablat	N	%	P
Gjinia			<b>&lt;0.01</b>
Femër	55	35.9	
Mashkull	98	64.1	
Mosha, M (SD)	65.3 (±12.5)		
Grupmosha			<b>&lt;0.01</b>
≤59 vj	33	21.6	
60-69 vj	66	43.1	
≥70 vj	54	35.3	
BMI, M SD	26 (±3.7)		
KPS, M SD	75.5 (±13.3)		
Duhanpirja			<b>&lt;0.01</b>
Duhanpirës	81	52.9	
Ish duhanpirës	54	35.3	
Asnjëherë	18	12.0	
Sëmundje shoqëruese			<b>0.04</b>
Po	89	58.2	
Jo	64	41.8	
Lloji i sëmundjeve			<b>&lt;0.01</b>
SKV	26	17.0	
Diabet	34	22.2	
Histori e AVC	11	7.2	
SRK	18	11.8	
Mënyra e diagnozës			<b>&lt;0.01</b>
Rastësore	72	47.1	
Simptoma	75	49.0	
Depistim	6	3.9	
Provat respiratore			<b>&lt;0.01</b>
FEV <sub>1</sub> > 60	144	94.1	
FEV <sub>1</sub> ≤ 60	9	5.9	
Imazheria			<b>&lt;0.01</b>
PET/CT	61	39.9	
EBUS	7	4.6	
Video-mediastinoskopi	2	1.3	

Në studim morën pjesë 153 pacientë me moshë mesatare 65.3 (±12.5) vjeç.



**Figura 3. 1 Shpërndarja e rasteve sipas gjinisë**


Shumica e pacientëve (64.1%) ishin meshkuj me ndryshim sinjifikant me femrat (35.9%) ( $p < 0.01$ ).



**Figura 3. 2 Shpërndarja e rasteve sipas grupmoshës**


Vërehet një trend në rritje të moshës së pacientëve, nga 21.6% në grupmoshën ≤59 vjeç në 43.1% në grupmoshën 60-69 vjeç dhe 35.3% në grupmoshën ≥70 vj, ( $p < 0.01$ ).

BMI mesatare e pacientëve është 26 ( $\pm 3.7$ )  
 Score mesatar i Karnofski është 75.5 ( $\pm 13.3$ ).



**Figura 3. 3 Statusi i duhanpirjes**


Në studim mbizotërojnë pacientët duhanpirës. Duhanpirës aktuale janë 52.9% e pacientëve, ish duhanpires 35.3% dhe jo duhanpires 12% ( $p<0.01$ ).



**Figura 3. 4 Frekuenca e sëmundjeve shoqëruese**


Shumica e pacientëve (58.2%) kanë sëmundje shoqëruese ndërsa 41.8% e tyre nuk kanë ( $p<0.01$ ).






**Figura 3. 5 Lloji i sëmundjeve shoqëruese**

Nga sëmundjet shoqëruese mbizotëron diabeti (22.2%) ndjekur nga SKV (17%) SRK (11.8%) dhe histori e AVC (7.2%) ( $p<0.01$ ).




**Figura 3. 6 Shpërndarja e rasteve sipas mënyrës së diagnostikimit**

Mënyra e diagnostikimit ishte rastesore në 47.1% të rasteve dhe prej simptomatologjisë në 49% të rasteve. Nëpërmjet depsitimit janë diagnostikuar 3.9% e rasteve ( $p < 0.01$ ).



**Figura 3. 7 Provat respiratore**

Në lidhje me provat respiratore FEV<sub>1</sub> > 60 kanë 94.1% e pacientëve ndërsa FEV<sub>1</sub> ≤ 60 kanë 3.9% e tyre ( $p < 0.01$ ).




**Figura 3. 8 Imazheria e përdorur**

PET/CT kanë bërë 39.9% e pacientëve, EBUS 4.6% dhe videomediastinoskopi 1.3%, ( $p < 0.01$ ).


**Tabela 3. 2 Karakteristikat e Ca pulmonar dhe stadifikimi**

<b>Variablat</b>	<b>N</b>	<b>%</b>	<b>P</b>
Diferencimi			<b>&lt;0.01</b>
Diferencë	36	23.5	
Mesatarisht i diferencuar	75	49.2	
I pa diferencuar	42	27.5	
Tipi Histopatologjik			<b>&lt;0.01</b>
Adenocarcinoma	65	42.5	
Ca me qeliza skuamoze	75	49.0	
Tipi i përzier	13	8.5	
Madhësia e tumourit			<b>&lt;0.01</b>
< 10 mm	8	5.2	
10-20 mm	18	11.8	
21-30 mm	33	21.6	
31-50 mm	48	31.4	
> 50 mm	46	30.1	
Prekja e limfonodulave			<b>&lt;0.01</b>
N <sub>0</sub>	101	66.0	
N <sub>1</sub>	42	27.5	
N <sub>2</sub>	10	6.5	
Prekje e pleurës parietale			<b>&lt;0.01</b>
Po	5	3.3	
Jo	148	96.7	
Stadi-TNM			<b>&lt;0.01</b>
IA	49	32.0	
IB	54	35.3	
IIA	19	12.4	
IIB	20	13.1	
IIIA	11	7.2	
Terapi Neoadjuvante			<b>&lt;0.01</b>
Po	5	3.3	
Jo	148	96.7	
Tipi i interventit			<b>&lt;0.01</b>
Pneumonektomi	41	26.8	
Lobektomi	95	62.1	
Bilobektomi	8	5.2	
Sublobare	9	5.9	
Komplikacione			<b>&lt;0.01</b>
Po	22	14.4	
Jo	131	85.6	
Ditëqëndrimi, M SD	6.5 (±1.6)		
Exitus			<b>&lt;0.01</b>
Po	10	6.5	
Jo	143	93.5	




**Figura 3. 9 Diferencimi i Ca**

Në studim mbizotëron diferencimi mesatar i Ca. Diferencimi i Ca pulmonar ishte i mirë në 23.5% të rasteve, mesatar në 49.2% të rasteve dhe i padiferencuar në 27.5% të rasteve ( $p<0.01$ ).




**Figura 3. 10 Tipi Histopatologjik**

Sipas tipit histologjik mbizotëron Ca me qeliza skuamoze (49%) ndjekur nga Adenocarcinoma (42.5%) dhe tipi i përzier (8.5%), ( $p<0.01$ ).




**Figura 3. 11 Madhësia e tumourit**

Mbizotëron madhësia e tumorit >30 mm (61.5%) e rasteve. Madhësia e tumourit <10 mm u gjet në 5.2% të pacientëve, 10-20 mm në 11.8%, 21-30 mm në 21.6%, 31-50 mm në 31.4% dhe >50 mm në 30.1%, ( $p<001$ ).




**Figura 3. 12 Prekja e limfonodulave**

Përsa i përket prekjes së limfonodulave me No janë 66% e pacientëve, N1 janë 27.5% dhe n2 janë 6.5%, ( $p < 0.01$ ).




**Figura 3. 13 Prekje e pleurës parietale**

Prekje e pleurës parietale u gjet në 3.3% të pacientëve.




**Figura 3. 14 Stadi - TNM**

Përsa i përket stadi TNM: Stadi IA janë 32% e pacientëve, IB janë 35.3%, IIA janë 12.4%, IIB janë 13.1% dhe IIIA janë 7.2%.




**Figura 3. 15 Terapi neoadjuvante**

Terapi Neoadjuvante kanë përdorur 3.3% e pacientëve.



**Figura 3. 16 Tipi i interventit**

Mbizotëron tipi i interventit lobektomi në 62.1% të pacientëve, ndjekur nga pneumonektomi (26.8%), sublobare (5.9%) dhe bilobektomi (5.2%), ( $p<0.01$ ).




**Figura 3. 17 Frekuenca e komplikacioneve**

Ditëqëndrimi mesatar spitalor është 6.5 ( $\pm 1.6$ ) ditë. Komplikacione kanë shfaqur 14.4% e pacientëve.

**Tabela 3. 3 Lloji i komplikacioneve**


Lloji i komplikacioneve	N	%
Komplikacione madhore		
Fistulabronkopleurale	4	2.6
Hemoragji postoperatore	2	1.3
Insuficiencë respiratore	1	0.7
Infarkt miokardi	1	0.7
Empiema	1	0.7
Insuficiencë renale	1	0.7
Komplikacione minore		
Rrjedhje ajri	5	3.3
Atelektazë	3	2.0
Aritmi supraventrikulare	2	1.3
Parezee nervit rekurrent	1	0.7
Pneumoni	1	0.7





**Figura 3. 18 Lloji i komplikacioneve**

Komplikacione madhore kanë shfaqur 6.5% e pacientëve ndërsa komplikacione minore 7.8% e tyre.




**Figura 3. 19 Lloji i komplikacioneve**

Komplikacionet madhore janë 4(2.6%) fistula bronkopleurale, 2 (1.3%) raste me hemoragji postoperatore dhe përkatësisht nga 1 (0.7%) raste me insuficiencë respiratore, infarkt miokardi, empiema dhe insuficiencë renale.

**Tabela 3. 4 Lloji i komplikacioneve: të hereshme dhe të vonshme**


Koha e komplikacioneve	N	%
<b><i>Të herëshme</i></b>		
Fistula bronkopleurale	1	0.7
Hemoragji postoperatore	2	1.3
Insuficiencë respiratore	1	0.7
Infarkt miokardi	1	0.7
Empiema	1	0.7
Insuficiencë renale	1	0.7
Rrjedhje ajri	5	3.3
Atelektazë	3	2.0
Aritmi supraventrikulare	2	1.3
Pareze e nervit rekurrent	1	0.7
Pneumoni	1	0.7
<b><i>Të vonëshme</i></b>		
Fistula bronkopleurale	3	2.0



**Figura 3. 20 Lloji i komplikacioneve: të hershme dhe të vonshme**


Komplikacione të hershme manifestuan 12.4% e pacientëve ndërsa komplikacione të vomshme 2% e tyre ( $p < 0.01$ ).

Komplikacionet në studim janë të gjitha grada Clavien-Dindo  $\geq 2$ .




**Figura 3. 21 Frekuenca e exitus**

Në exitus kanë përfunduar 10 pacientë ose 6.5% e totalit të tyre (95% CI 3.1. – 11.6)



**Figura 3. 22 Probabiliteti i mbijetesës së përgjithshme 30 ditore**

Mbijetesja mesatare për periudhën 30 ditore për të gjitha stadet është 91.8% (95% CI 83.2 -100.0)




**Figura 3. 23 Probabiliteti i mbijetesës së përgjithshme 30 ditore sipas stadeve**

Nuk u gjet ndryshim sinjifikant në krahasimin e mbijetesës 30 ditore të pacientëve sipas stadeve (Kaplan – Meier logrank test= 2.5 p=0.7)


Probabiliteti i mbijetesës 30 ditore sipas stadeve:

- IA është 88.9%
- IB është 85.7%
- IIA është 100.0%
- IIB është 83.30%
- IIIA është 100%



### Figura 3. 24 Probabiliteti i mbijetesës së përgjithshme 90 ditore

Mbijetesja mesatare për periudhën 90 ditore për të gjitha stadet është 61.2% (95%CI 32.4– 90.3).




### Figura 3. 25 Probabiliteti i mbijetesës së përgjithshme 90 ditore sipas stadeve

Nuk u gjet ndryshim sinjifikant në krahasimin e mbijetesës 90 ditore të pacientëve sipas stadeve (Kaplan – Meier logrank test= 2.8 p=0.6)


Probabiliteti i mbijetesës 90 ditore sipas stadeve:

- IA është 87.5%
- IB është 83.3%
- IIA është 80.0%
- IIB është 75.0%
- IIIA është 65.6%



**Figura 3. 26 Probabiliteti i mbijetesës së përgjithshme 5 vjeçare**

Mbijetesa mesatare për periudhën 5 vjeçare për të gjitha stadet është 65.6% (95% CI 48.5 – 83.4), ose 46.9 muajose 4 vjet.



**Figura 3. 27 Probabiliteti i mbijetesës sipas stadeve për periudhën e ndjekjes 5 vjeçare.**

U gjet ndryshim sinjifikant në krahasimin e mbijetesës 5 vjeçare të pacientëve sipas stadeve (Kaplan – Meier logrank test= 5.5 p=0.02).


Probabiliteti i mbijetesës5 vjeçare sipas stadeve:

- IA është 87.5%
- IB është 83.3%
- IIA është 80.0%
- IIB është 75.0%
- IIIA është 16.2%

Mbijetesa në stadin IA, dhe IB ka ndryshim sinjifikant me stadin IIIA.


**Tabela 3. 5 Risku Hazard me 95% CI sipas stadeve**

Factor	IA	IB	IIA	IIB	IIIA
IA	-	1.31 0.20 - 8.46	1.72 0.2 - 13.0	2.08 0.24 - 17.97	5.48 1.7 - 29.9
IB	0.76 0.1 - 4.9	-	1.31 0.15 - 11.1	1.5 0.16 - 15.2	4.18 1.3 - 26.0
IIA	0.58 0.07 - 4.3	0.78 0.08 - 6.45	-	1.21 0.11 - 13.2	3.18 0.72 - 23.3
IIB	0.4 0.05 - 4.13	0.62 0.06 - 6.03	0.82 0.07 - 9.03	-	2.63 0.31 - 22.01
IIIA	0.1822 0.03 - 0.96	0.23 0.03 - 1.49	0.31 0.042 - 2.29	0.38 0.04 - 3.18	-



**Figura 3. 28 Risku Hazard me 95% CI sipas stadeve**

Vërehet qe HR është më i lartë për stadin IIIA krahasuar me stadin IA (HR=5.48 p<0.01),stadin IB (HR=4.18 p=0.02) dhe stadin IIA (HR=3.18 p=0.04).



**Figura 3. 29** Krahasimi i probabilitetit të mbijetesës sipas tipit të interventit

U gjet ndryshim sinjifikant në krahasimin e mbijetesës 5 vjeçare të pacientëve sipas tipit të interventit (Kaplan – Meier logrank test= 3.8 p=0.04).

Probabiliteti i mbijetesës sipas tipit të interventit:

- lobektomi është 87.5%.
- bilobektomi është 81.8%
- sublobare është 30%
- pneumonektomi është 43%


Mbijetesë në tipin e interventit lobektomi ka ndryshim sinjifikant me tipin sublobar.

Vërehet qe HR është më i lartë për intervention sublobarkrahasuar me lobektomine (HR=5.24 p=0.04).



**Tabela 3. 6 Tipi i vdekjeve**

Tipi i vdekjeve	N	%
Me komplikacione	7	70.0
Pa komplikacione	3	30.0
Total	10	100.0




**Figura 3. 30 Tipi i vdekjeve**

Nga 10 vdekje 7 (70%) e tyre janë me komplikacione ndërsa 3 (30%) e tyre janë pa komplikacione.

**Tabela 3. 7 Shkaku i vdekjeve dhe prania e komplikacioneve**

Shkaku i vdekjeve	Me komplikacione (n=7)	Pa komplikacione (n=3)	P
Ca. primar i pulmonit	4 (57.1)	1 (33.3)	0.5
Ca. jo primar pulmonit			
Respirator	2 (28.6)		0.3
Kardiovaskular	1 (14.3)	1 (33.3)	0.5
Tjetër		1 (33.3)	0.1




**Figura 3. 31 Shkaku i vdekjeve dhe prania e komplikacioneve**

Nuk u gjet ndryshim sinjifikan i shkaktut të vdekjes dhe pranisë së komplikacioneve.

Nga 7 pacientët me exitus që manifestuan komplikacione 4 (57.1%) prej tyre kishin Ca. primar të pulmonit, 2 (28.6%) shkak respirator dhe 1 (14.3%) shkak kardiovaskular.

Nga 3 pacientët me exitus që nuk manifestuan komplikacione 1 (33.3%) pacient kishte Ca. primar të pulmonit, 1 (33.3%) shkak kardiovaskular dhe 1 (33.3%) shkak tjetër.



**Figura 3. 32 Mbijetesë 5-vjeçare e pacientëve në lidhje me praninë e komplikacioneve**

Nuk u gjet ndryshim sinjifikant në krahasimin e mbijetesës 5-vjeçare të pacientëve në lidhje me praninë e komplikacioneve (Kaplan – Meier logrank test= 0.8 p=0.3) për arsye të numrit të vogël të rasteve.

Mbijetesë 5-vjeçare e pacientëve me komplikacione është 58.8% (95% CI 36.4 – 82.1) ndërsa e pacientëve pa komplikacione është 77.5% (95% CI 57.3 –95.6)


**Tabela 3. 8 Analiza multivariate e faktorëve të riskut për exitus. Regresioni i Cox**

Variablat	HR	95%CI	P
Gjinia/ meshkuj	1.91	1.25 – 2.93	<b>0.01</b>
Mosha	1.16	1.13 – 1.89	<b>&lt;0.01</b>
KPS, M SD	1.88	1.15 – 2.62	
Duhanpirja			
Asnjeherë	ref		
Ish duhanpirës	1.33	0.18 – 3.64	0.4
Duhanpirës	2.26	1.32 – 3.21	<b>0.02</b>
Sëmundje shoqëruese	2.19	1.20 – 4.86	
Diferencimi			
I mirë	ref		
Mesatar	1.97	1.12 – 3.21	<b>0.03</b>
I ulët	1.21	0.78 – 2.56	0.2
Tipi Histopatologjik			
Adenocarcinoma	ref		
Ca me qeliza skuamoze	2.41	1.32 – 3.13	<b>&lt;0.01</b>
Ca me qeliza bronkoalveolare	1.18	0.67 – 2.16	0.4
Tipi i përzier	1.10	0.85 – 2.96	0.6
Madhësia e tumourit			
< 10 mm	ref		
10-20 mm	1.08	0.56 – 2.31	0.7
21-30 mm	1.12	0.63 – 2.59	0.5
31-50 mm	1.55	0.89 – 2.87	0.3
> 50 mm	2.34	1.28 – 3.18	<b>&lt;0.01</b>
Prekja e limfonodulave			
N <sub>0</sub>	ref		
N <sub>1</sub>	1.21	0.84 – 2.87	0.6
N <sub>2</sub>	1.93	1.12 – 3.96	<b>&lt;0.01</b>
Stadi-TNM			
IA	ref		
IB	1.31	0.76 – 3.54	0.5
IIA	1.40	0.81 – 3.21	0.3
IIB	1.64	0.90 – 3.42	0.1
IIIA	2.93	1.70 – 3.63	<b>&lt;0.01</b>
Tipi i interventit			
Lobektomi	ref		
Bilobektomi	1.50	0.80–3.72	0.6
Pneumonektomi	3.45	2.38–5.86	<b>&lt;0.01</b>
Sublobare	1.49	0.44–6.16	0.7
Komplikacione	3.52	1.95–4.17	<b>&lt;0.01</b>

Në analizën multivariate të regresionit Cox, që kontrollon për konfunduesit e mundshëm, faktorë sinjifikante dhe të pavarur të mortalitetit rezultuan:

- Gjinia/ meshkuj
- Mosha e madhe

- Duhanpirës
- Diferencimi mesatar i tumorit
- Tipi Histopatologjik: Ca me qeliza skuamoze
- Madhësia e tumourit > 50 mm
- Prekja e limfonodulave N<sub>2</sub>
- Stadi-TNM IIIA
- Tipi i interventit pneumonektomi
- Komplikacionet



**Figura 3. 33 Analiza multivariate e faktorëve të riskut për exitus. Regresioni i Cox**

## IV DISKUTIM

Qëllimet e terapisë kirurgjikale për NSCLC janë kryerja e një interventi të sigurt dhe efektiv në mënyrë që të arrihet rezeksioni i plotë me marzhe negative dhe pastrim adekuat të nyjeve limfatike që janë në rrezik ose të përfshirë dhe për të rikthyer një pacient në një gjendje funksionale ose t'i nënshtrohet terapisë shtesë ose të kthehet në aktivitetet e tij para operacionit. Testet e funksionit pulmonar dhe vlerat e parashikuara pas operacionit përdoren për të vlerësuar aftësinë e pacientit për t'iu nënshtuar reseksionit në mënyrë të sigurt dhe të kombinuara me gjendjen kardiovaskulare dhe sëmundjet shoqëruese që mund të paraqesin kundërrindikacione. Zgjedhja e procedurës dhe qasjes vjen me vendimin për të vepruar [79-82].

Ky studim u krye për vlerësimin e rolit të trajtimit kirurgjikal të kancerit pulmonar dhe i prognozës sipas klasifikimit të TNM. Në studim morën pjesë 153 pacientë me moshë mesatare 65.3 ( $\pm 12.5$ ) vjeç. Shumica e pacientëve (64.1%) ishin meshkuj me ndryshim sinjifikant me femrat (35.9%).

BMI mesatar e pacientëve ishte 26 ( $\pm 3.7$ ) ndërsa KPS mesatar ishte 75.5 ( $\pm 13.3$ ).

Vërehet një trend në rritje të moshës së pacientëve, nga 21.6% në grupmoshën  $\leq 59$  vjeç në 43.1% grupmoshën 60-69 vjeç dhe 35.3% në grupmoshën  $\geq 70$  vjeç.

Në studim mbizotërojnë pacientët duhanpirës. Duhanpirës aktuale janë 52.9% e pacientëve, ish duhanpirës 35.3% dhe jo duhanpirës 12%.

Shumica e pacientëve (58.2%) kanë sëmundje shoqëruese ndërsa 41.8% e tyre nuk kanë. Nga sëmundjet shoqëruese mbizotëron diabeti (22.2%) ndjekur nga SKV (17%) SRK (11.8%) dhe histori e AVC (7.2%).

Mënyra e diagnostikimit ishte rastësore në 47.1% të rasteve dhe prej simptomatologjisë në 49% të rasteve. Nëpërmjet deptsimit janë diagnostikuar 3.9% e rasteve.

Në lidhje me provat respiratore  $FEV_1 > 60$  kanë 94.1% e pacientëve ndërsa  $FEV_1 \leq 60$  kanë 3.9% e tyre. PET/CT kanë bërë 39.9% e pacientëve, EBUS 4.6% dhe videomediastinoskopi 1.3%. Në studim mbizotëron diferencimi mesatar i Ca. Diferencimi i Ca pulmonar ishte i mirë në 23.5% të rasteve, mesatar në 49.2% të rasteve dhe i ulët në 27.5% të rasteve ndërsa CT toraksi kanë kryer të gjithë pacientët. Sipas tipit histologjik mbizotëron Ca me qeliza skuamoze (49%) ndjekur nga Adenocarcinoma (42.5%), dhe tipi i përzier (8.5%). Mbizotëron madhësia e tumorit  $> 30$  mm (61.5%) e rasteve. Madhësia e tumorit  $< 10$  mm u gjet në 5.2% të pacientëve, 10-20 mm në 11.8%, 21-30 mm në 21.6%, 31-50 mm në 31.4% dhe  $> 50$  mm në 30.1%.

Përsa i përket prekjes së limfonodulave me No janë 66% e pacientëve, N<sub>1</sub> janë 27.5% dhe N<sub>2</sub> janë 6.5%. Prekje e pleurës parietale u gjet në 3.3% të pacientëve.

Përsa i përket stadi TNM: Stadi IA janë 32% e pacientëve, IB janë 35.3%, IIA janë 12.4%, IIB janë 13.1% dhe IIIA janë 7.2%. Terapi Neoadjuvante kanë përdorur 3.3% e pacientëve.

Mbizotëron tipi i interventit lobektomi në 62.1% të pacientëve, ndjekur nga pneumonektomi (26.8%), sublobare (5.9%) dhe bilobektomi (5.2%). Studiuesit po vlerësojnë rezultatet nga rezeksionet sublobare në krahasim me lobektomitë ose pneumonektomitë, duke ofruar të dhëna veçanërisht për madhësinë e tumorit dhe statusin nodal, duke vendosur lobektominë si rezeksionin standard dhe më të zakonshëm onkologjik [83-86] ndërsa studimet retrospektive sugjerojnë që rezeksionet sublobare mund të kryhen në një grup shumë të përzgjedhur të pacientëve. [87-90].

Ditëqëndrimi mesatar spitalor është 6.5 ( $\pm 1.6$ ) ditë. Komplikacione kanë shfaqur 14.4% e pacientëve.

Në exitus kanë përfunduar 10 pacientë ose 6.5% e totalit të tyre (95% CI 3.1. – 11.6)

Komplikacione madhore kanë shfaqur 6.5% e pacientëve ndërsa komplikacione minore 7.8% e tyre.

Komplikacionet madhore janë 4(2.6%) fistula bronkopleurale, 2 (1.3%) raste me hemoragji postoperative dhe përkatësisht nga 1 (0.7%) raste me insuficiencë respiratore, infarkt miokardi, empiema dhe insuficiencë renale.

Komplikacione të hershme manifestuan 12.4% e pacientëve ndërsa komplikacione të vonshme 2% e tyre. Komplikacionet në studim janë të gjitha grada Clavien-Dindo  $\geq 2$ . [91-95] Komplikacionet postoperative janë të zakonshme tek pacientët që i nënshtrohen rezeksionit kirurgjik të kancerit të mushkërive me qeliza jo të vogla (NSCLC). Studimet kanë publikuar nivelin e komplikacioneve që variojnë nga 9% në 37%, me vdekshmëri 30-ditore. postoperative prej 3% ose më pak për pacientët që i nënshtrohen lobektomisë për NSCLC [96-100] Nuk ka dyshim se sëmundshmëria e parashikuar pas operacionit dhe ndikimi i tij negativ pasues në cilësinë e jetës ndikon në marrjen e vendimeve kirurgjikale, veçanërisht për pacientët e moshuar të cilët mund të kenë më shumë gjasa të marrin terapi onkologjike jo-optimale. Vdekshmëria dhe sëmundshmëria peri-operative vazhdojnë të përmirësohen pas operacionit torakal. Përdorimi i analgjezisë multimodale dhe reduktimi i stresit kirurgjik ka çuar në përmirësimin e rezultateve post-operative duke përfshirë kontrollin e dhimbjes [101-105], uljen e gjatësisë të qëndrimit, dhe ulje të sëmundshmërisë pulmonare dhe kardiake gjatë operacioneve të hapura. [106-110].

Mbijetesja mesatare për periudhën 30 ditore për të gjitha stadet është 91.8% pa ndryshim sinjifikant sipas stadeve. Mbijetesja mesatare për periudhën 90 ditore për të gjitha stadet është 61.2% ose 84.5 ditë (95% CI 73.7 - 95.1) pa ndryshim sinjifikant sipas stadeve.

Mbijetesja mesatare për periudhën 5 vjeçare për të gjitha stadet është 65.6% ose 46.9 muaj (95% CI 39.02 – 54.8) ose 4 vjet.

U gjet ndryshim sinjifikant në krahasimin e mbijetesës 5 vjeçare të pacientëve sipas stadeve (Kaplan – Meier logrank test= 5.5 p=0.02).

Probabiliteti i mbijetesës 5 vjeçare sipas stadeve:

- IA është 87.5%; -IB është 83.3%; - IIA është 80.0%; - IIB është 75.0%; - IIIA është 16.2%

Mbijetesja në stadin IA, IB dhe IIA ka ndryshim sinjifikant me stadin IIIA.

Vërehet që HR është më i lartë për stadin IIIA krahasuar me stadin IA (HR=5.48 p<0.01), stadin IB (HR=4.18 p=0.02) dhe stadin IIA (HR=3.18 p=0.04).

U gjet ndryshim sinjifikant në krahasimin e mbijetesës 5 vjeçare të pacientëve sipas tipit të interventit (Kaplan – Meier logrank test= 3.8 p=0.04).

Probabiliteti i mbijetesës sipas tipit të interventit rezultoi: -lobektomi është 87.5%; -bilobektomi është 81.8%; -sublobare është 30%; -pneumonektomi është 43%.

Mbijetesa në tipin e interventit lobektomi ka ndryshim sinjifikant me tipin sublobar.

Vërehet që HR është më i lartë për intervention sublobarkrahasuar me lobektomine (HR=5.24 p=0.04) Nga 10 vdekje 7 (70%) e tyre janë me komplikacione ndërsa 3 (30%) e tyre janë pa komplikacione. Nuk u gjet ndryshim sinjifikant i shkakut të vdekjes dhe pranisë së komplikacioneve.

Nga 7 pacientet me exitus që manifestuan komplikacione 4 (57.1%) prej tyre kishin Ca. primar të pulmonit, 2 (28.6%) shkak respirator dhe 1 (14.3%) shkak kardiovaskular.

Nga 3 pacientët me exitus që nuk manifestuan komplikacione 1 (33.3%) pacient kishte Ca. primar të pulmonit, 1 (33.3%) shkak kardiovaskular dhe 1 (33.3%) shkak tjetër.

Nuk u gjet ndryshim sinjifikant në krahasimin e mbijetesës 5-vjeçare të pacientëve në lidhje me praninë e komplikacioneve për arsye të numrit të vogël të rasteve.

Mbijetesa 5-vjeçare e pacientëve me komplikacione është 58.8% (95% CI 36.4 – 82.1) ndërsa e pacientëve pa komplikacione është 77.5% (95% CI 57.3 – 95.6)

Në analizën multivariate të regresionit Cox, që kontrollon për konfunduesit e mundshëm, faktorë sinjifikante dhe të pavarur të mortalitetit rezultuan:-Gjinia/ meshkuj; -Moshë e madhe; -Duhanpirësit; -Diferencimi mesatar i tumorit; -Tipi Histopatologjik: Ca me qeliza skuamoze; -Madhësia e tumorit > 50 mm; -Prekja e limfonodulave N<sub>2</sub>; -Stadi-TNM IIIA; -Tipi i interventit pneumonektomi; -Komplikacionet.

Gjetjet e studimit tonë janë të ngjashme me studime të tjera të raportuara në literaturë. Niveli i komplikacioneve në studimin tonë është më i ulët krahasuar me studime të tjera që raportojnë në nivel prej 21.1%, me ndërlikimet që zakonisht klasifikoheshin si të vogla 16.4%. [111-120]. Gjithashtu, edhe niveli i komplikacioneve madhore në studimin tonë është më i ulët krahasuar me 4.7%, që raportohet në një studim në literaturë. Komplikacionet e tjera postoperative në studimin aktual ishin gjithashtu në përputhje me studimet e raportuara në literaturë. [121-127].

Shkalla e komplikacioneve postoperative pas rezeksionit të mushkërive është raportuar më parë të jetë 9-53.4%. [128-132] Për më tepër, sipas klasifikimit Clavien-Dindo, komplikacionet postoperative ndodhin në një nivel prej 39%-53.4%. [133-136]

Klasifikimi Clavien-Dindo ka rezultuar të jetë jashtëzakonisht i besueshëm dhe përdoret nga kirurgët torakale në mbarë botën. [137-139] Komplikacionet e përcaktuara nga ky sistem gradimi u shoqëruan me qëndrimin e zgjatur në spitalor [140], vdekshmërinë dhe rritjen e shkallës së ripranimit. [141]

Një studim i mëparshëm retrospektiv tregoi se komplikacionet pulmonare postoperative në pacientët me NSCLC rritën incidencën gjatë gjithë jetës së pneumonisë pas rezeksionit



të mushkërive. [142] Këto raporte sugjerojnë se një rritje e vdekjeve për shkak të kancerit jo-primar të mushkërive shoqërohet me mbijetesë të ulët në pacientët me NSCLC me komplikacione postoperative. Komplikacionet postoperative stimulojnë zhvillimin dhe rikthimin e kancerit. Prognoza e keqe pas komplikacioneve postoperative mund të shpjegohet biologjikisht nga rritja e statusit inflamator pas këtyre komplikacioneve. Inflamacioni sistemik me nivele të ngritura të leukociteve, proteinës C-reaktive, interleukinës-6 dhe faktorit- $\alpha$  të nekrozës së tumorit mund të lidhet me përparimin e tumorit dhe metastazat e largëta përmes efekteve imunomoduluese. [143] Rritja e statusit inflamator pas komplikacioneve postoperative nxit ngjitjen e qelizave tumorale me qelizat endoteliale vaskulare dhe organet e tjera; prandaj, komplikacionet postoperative mund të kenë një rol të rëndësishëm në përsëritjen e kancerit dhe mbijetesë të ulët. [144] Për më tepër, stresi kirurgjik frenon sistemin imunitar të pacientit përmes një rritje të numrit të qelizave T rregullatore. [145] Transfuzioni i gjakut dhe procedurat kirurgjikale invazive pas komplikacioneve postoperative, të cilat mund të fenojnë sistemin imunitar, shoqërohen me përsëritjen e kancerit. [146]

Strategjia e menaxhimit për trajtimin e kancerit të mushkërive me qeliza jo të vogla është transformuar nga kuptimi ynë i përmirësuar i biologjisë së kancerit dhe zhvillimi shoqëruar i terapive të reja sistemike. Rezekcioni i plotë kirurgjik i NSCLC vazhdon të ofrojë shansin më të mirë për kurimin ose kontrollin lokal dhe rajonal të sëmundjes, dhe me përmirësimet në teknikat minimalisht invazive dhe rikuperimin e përmirësuar, sëmundshmëria e lidhur me rezeksionin kirurgjik është zvogëluar. Diskutimet shumëdisiplinore të përqendruara te pacienti që marrin në konsideratë terapinë kirurgjikale shoqërohen me rezultate të përmirësuara. Të pajisura me modalitete të reja terapeutike premtuese, duke përfshirë frenuesit e pikave të kontrollit imunitar me ose pa kimioterapi, radioterapi stereotaktike dhe terapi sistemike të synuara, indikacionet për kirurgji vazhdojnë të zhvillohen dhe janë zgjeruar për të përfshirë pacientë të përzgjedhur me sëmundje të avancuar. Me hapat e fundit të bërë në fushën e onkologjisë torakale, menaxhimi i NSCLC po evoluon me shpejtësi. Duhet të ndiqet me kujdes përzgjedhja e pacientit dhe koha e terapisë me shumë modalitete për të lejuar optimizimin e përfitimit terapeutik. Ndërsa kimioterapia dhe radioterapia vazhdojnë të kenë një rol në menaxhimin e kancerit të mushkërive, terapia kirurgjikale mbetet një komponent thelbësor i trajtimit të kancerit të mushkërive në fazat e hershme, të avancuara në nivel lokal dhe rajonal, si dhe në raste të përzgjedhura të sëmundjes metastatike. [147]

Vdekshmëria dhe sëmundshmëria peri-operative vazhdojnë të përmirësohen me aplikimin erikuperimitte zgjeruar pas kirurgjisë torakale. Përdorimi i post-operatorit ambulimit i hershëm, analgjezia multimodale pa opioide dhe reduktimi i stresit kirurgjik ka çuar në përmirësimin e rezultateve post-operative duke përfshirë kontrollin e dhimbjes, uljen e kohëzgjatjes së qëndrimit dhe uljen e sëmundshmërisë pulmonare dhe kardiake gjatë operacioneve të hapura [148].

## V PËRFUNDIME

Mbizotëron Stadi IA dhe stadi IB, me madhësi tumori >30 mm, tipi histologjik Ca me qeliza skuamoze ndjekur nga Adenocarcinoma me diferencim mesatar të cilat gjithashtu rezultojnë faktorë risku për vdekshmerinë postoperatore.

1/3 e pacientëve kanë prekje të limfonodulave mediastinale.

Niveli i komplikacioneve dhe mbijetesës 5 vjeçare e krahasueshme me të dhënat në literaturë.

Stadet e herëshme IA dhe IB dhe tipi i interventit lobektomi kanë mbijetesë më të lartë.

Menaxhimi kirurgjikal mbetet standardi i trajtimit për kancerin e hershëm të mushkërive me qeliza jo të vogla dhe lobektomia interventi i zgjedhur.

Komplikacione madhore kane shfaqur 6.5% e pacientëve ndërsa komplikacione minore 7.8% e tyre.

Në exitus kanë përfunduar 6 pacientë ose 3.9% e totalit të tyre (95% CI 1.43 - 8.3).

Komplikacionet madhore janë 4(2.6%) fistula bronkopleurale, 2 (1.3%) raste me hemoragji postoperatore dhe përketesisht nga 1 (0.7%) raste me insuficiencë respiratore, infarkt miokardi, empiema dhe insuficiencë renale.

Mbijetesës mesatare për periudhën 90 ditore për të gjitha stadet është 84.5 ditë (95% CI 73.7 - 95.16).

Mbijetesës mesatare për periudhën 5 vjeçare për të gjitha stadet është 48 muaj ditë (95% CI 39.500 56.636) ose 4 vjet.

Probabiliteti i mbijetesës në stadin IA është 87.5%.  
Probabiliteti i mbijetesës në stadin IB është 83.3%.  
Probabiliteti i mbijetesës në stadin IIA është 80%.  
Probabiliteti i mbijetesës në stadin IIB është 75%.  
Probabiliteti i mbijetesës në stadin IIIA është 65.6%.

HR është më i lartë për stadin IIIA krahasuar me stadin IA (HR=2.95) dhe stadin IB (HR=3.68).

Probabiliteti i mbijetesës sipas tipit të interventit:

- lobektomi është 87.5%.
- bilopektomi është 80%
- sublobare është 75%
- pneumonektomi është 65.6%

Në analizën multivariate të regresionit Cox, që kontrollon për konfunduesit e mundshëm, faktorë sinjifikante dhe të pavarur të mortalitetit rezultuan:

- Gjinia/ meshkuj
- Mosha e madhe
- Duhanpirës
- Diferencimi mesatar i tumorit
- Tipi Histopatologjik: Ca me qeliza skuamoze
- Madhësia e tumourit > 50 mm
- Prekja e limfonodulave N<sub>2</sub>
- Stadi-TNM IIIA
- Tipi i interventit pneumonektomi
- Komplikacionet

Niveli i komplikacioneve dhe mbijetesës 5 vjeçare e krahasueshme me të dhënat në literaturë

Stadet e herëshme IA dhe IB dhe tipi i interventit lobektomi kanë mbijetesë më të lartë.

Menaxhimi kirurgjikal mbetet standardi i trajtimit për kancerin e hershëm të mushkërive me qeliza jo të vogla dhe lobektomia interveni i zgjedhur.

## **VI REKOMANDIME**

Vlerësimi i detajuar preoperator në lidhje me stadin TNM

Historia dhe ekzaminimi fizik dhe CT e toraksit me ose pa kontrast çdo 6-12 muaj për 2-3 vjet, më pas një vizitë dhe ekzaminim fizik dhe CT skan i toraksit pa kontrast çdo vit.

Vlerësimi i statusit të pirjes së duhanit në çdo vizitë, me këshillim dhe referim për lënien e duhanit sipas nevojës.

Rekomandime të tjera të NCCN për monitorimin afatgjatë përfshijnë si më poshtë:

- Vaksinimi vjetor për Gripin; vaksinimi për pneumokokun me doza rivaksinimi sipas rastit; vaksinim për herpes zoster.
- Këshillim rreth promovimit të shëndetit dhe mirëqënies (aktivitet fizik i rregullt, dieta ushqimore).
- Monitorimi rutinë i shëndetit.

## VII SHTOJCA

### **Nëpërmjet një skede individuale u mblodhën të dhënat sociodemografike dhe klinike**

Të dhënat sociodemografike:

- Moshë
- Gjinia
- BMI

Ish-duhanpirës u përkufizuan si pacientë që kishin lënë duhanin më shumë se 5 vjet përpara operacionit, dhe ata që nuk pinë kurrë duhan u përkufizuan si pacientë që kishin pirë më pak se 100 cigare gjatë jetës së tyre.

Në vlerësimet klinike përfshihen:

- Sëmundjet shoqëruese
- Indeksi Karnovski
- Mënyra e diagnozës
- Provat respiratore

-Ekzaminimet imazherike

PET/CT

EBUS

Video-mediastinoskopi

Karakteristikat e Ca Pulmonar dhe stadifikimi

- Diferencimi
- Tipi Histopatologjik
- Madhësia e tumourit
- Prekja e limfonodulave mediastinale dhe hilare
- Prekje e pleurës parietale
- Stadi
- Tipi i interventit

Frekuenca dhe lloji i komplikacioneve

Ditëqëndrimi

Frekuenca e exitus

Të gjithë pacientet u ndoqën periodikisht me CT pas interventit në:

- 3 muaj,
- 6 muaj,
- 1 vit,
- 2 vjet
- 3 vjet
- 5 vjet

## VII BIBLIOGRAFIA

1. [Guideline] Rivera MP, Mehta AC, Wahidi MM. Establishing the diagnosis of lung cancer: Diagnosis and management of lung cancer,3rd ed: American College of Chest Physicians evidence-based clinical practice guidelines. *Chest*. 2013 May. 143 (5 Suppl):e142S-e165S. [QxMD MEDLINE Link]. [Full Text].
2. Rowell NP, Williams CJ. Radical radiotherapy for stage I/II non-small cell lung cancer in patients not sufficiently fit for or declining surgery (medically inoperable): a systematic review. *Thorax*. 2001 Aug. 56(8):628-38. [QxMD MEDLINE Link].
3. Strand TE, Brunsvig PF, Johannessen DC, et al. Potentially curative radiotherapy for non-small-cell lung cancer in Norway: a population-based study of survival. *Int J Radiat Oncol Biol Phys*. 2011 May 1. 80(1):133-41. [QxMD MEDLINE Link].
4. Wang HM, Liao ZX, Komaki R, et al. Improved survival outcomes with the incidental use of beta-blockers among patients with non-small-cell lung cancer treated with definitive radiation therapy. *Ann Oncol*. 2013 Jan 8. [QxMD MEDLINE Link].
5. Rosen G. *A History of Public Health: Expanded Edition*. Baltimore, MD.: The Johns Hopkins University Press; 1993.
6. Siegel RL, Miller KD, Fuchs HE, Jemal A. Cancer statistics, 2022. *CA Cancer J Clin*. 2022 Jan. 72 (1):7-33. [QxMD MEDLINE Link]. [Full Text].
7. National Research Council, Committee on Health Risks of Exposure to Radon, Board on Radiation Effects Research, Commission on Life Sciences. *Health effects of exposure to radon (BEIR VI)*. Washington, DC.: National Academy Press.; 1999.
8. Ito H, Matsuo K, Tanaka H, et al. Nonfilter and filter cigarette consumption and the incidence of lung cancer by histological type in Japan and the United States: analysis of 30-year data from population-based cancer registries. *Int J Cancer*. 2011 Apr 15. 128(8):1918-28. [QxMD MEDLINE Link].
9. Zhang J, Fujimoto J, Zhang J, et al. Intratumor heterogeneity in localized lung adenocarcinomas delineated by multiregion sequencing. *Science*. 2014 Oct 10. 346(6206):256-9. [QxMD MEDLINE Link].
10. de Bruin EC, McGranahan N, Mitter R, et al. Spatial and temporal diversity in genomic instability processes defines lung cancer evolution. *Science*. 2014 Oct 10. 346(6206):251-6. [QxMD MEDLINE Link].
11. Molina JR, Yang P, Cassivi SD, Schild SE, Adjei AA. Non-small cell lung cancer: epidemiology, risk factors, treatment, and survivorship. *Mayo Clin Proc*. 2008 May. 83(5):584-94. [QxMD MEDLINE Link]. [Full Text].
12. Nelson R. Lung Cancer Rates Surging in Never-Smokers. *Medscape Medical News*. Available at <http://www.medscape.com/viewarticle/850708>. September 9, 2015; Accessed: February 9, 2022.
13. Beckett WS. Epidemiology and etiology of lung cancer. *Clin Chest Med*. 1993 Mar. 14(1):1-15. [QxMD MEDLINE Link].

14. Bagnardi V, Rota M, Botteri E, et al. Alcohol consumption and lung cancer risk in never smokers: a meta-analysis. *Ann Oncol.* 2011Dec. 22(12):2631-9. [QxMD MEDLINE Link].
15. Current Cigarette Smoking Among Adults in the United States. Centers for Disease Control and Prevention. Available at [https://www.cdc.gov/tobacco/data\\_statistics/fact\\_sheets/adult\\_data/cig\\_smoking/index.htm](https://www.cdc.gov/tobacco/data_statistics/fact_sheets/adult_data/cig_smoking/index.htm). December 10, 2020; Accessed: February 9, 2022.
16. GBD 2019 Tobacco Collaborators. Spatial, temporal, and demographic patterns in prevalence of smoking tobacco use and attributable disease burden in 204 countries and territories, 1990-2019: a systematic analysis from the Global Burden of Disease Study 2019. *Lancet.* 2021 Jun 19. 397 (10292):2337-2360. [QxMD MEDLINE Link]. [Full Text].
17. Ginsberg RJ, Vokes EE, Raben A. Non-small cell lung cancer. In: DeVita VT Jr, Hellman S, Rosenberg SA, eds. *Cancer: Principles and Practice of Oncology.* 5th ed. Philadelphia, Pa: Lippincott-Raven; 1997:858-911.
18. Vainshelboim B, Lima RM, Kokkinos P, Myers J. Cardiorespiratory Fitness, Lung Cancer Incidence, and Cancer Mortality in Male Smokers. *Am J Prev Med.* 2019 Nov. 57 (5):659-666. [QxMD MEDLINE Link].
19. Zhong L, Goldberg MS, Parent ME, Hanley JA. Exposure to environmental tobacco smoke and the risk of lung cancer: a meta-analysis. *Lung Cancer.* 2000 Jan. 27(1):3-18. [QxMD MEDLINE Link].
20. Alberg AJ, Brock MV, Ford JG, Samet JM, Spivack SD. Epidemiology of lung cancer: Diagnosis and management of lung cancer, 3rd ed: American College of Chest Physicians evidence-based clinical practice guidelines. *Chest.* 2013 May. 143(5 Suppl):e1S-29S. [QxMD MEDLINE Link].
21. Hou W, Fu J, Ge Y, Du J, Hua S. Incidence and risk of lung cancer in HIV-infected patients. *J Cancer Res Clin Oncol.* 2013 Nov. 139(11):1781-94. [QxMD MEDLINE Link].
22. Cortes-Jofre M, Rueda JR, Corsini-Munoz G, Fonseca-Cortes C, Caraballoso M, Bonfill Cosp X. Drugs for preventing lung cancer in healthy people. *Cochrane Database Syst Rev.* 2012 Oct 17. 10:CD002141. [QxMD MEDLINE Link].
23. Ries L, Eisner M, Kosary C. Cancer statistics review, 1975-2002. National Cancer Institute.; 2005.
24. World Health Organization, International Agency for Research on Cancer. Globocan 2020: Lung Cancer. International Agency for Research on Cancer.

- Available at <http://gco.iarc.fr/today/data/factsheets/cancers/15-Lung-fact-sheet.pdf>. Accessed: March 2, 2021.
